



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bankieri

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Nr. 3 Prill 2012

ISSN 2225-2959



9 772225 295004



Besimi NË
BANKINGUN KLASIK



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

NË BANKËN TUAJ
mund të përfitoni nga
të gjitha shërbimet dhe
produktet financiare
që ju ofrohen!

ANETARËT E AAB

 ALPHA BANK

 BKT
BANKA KOMERCIALE TREGTARE

 CREDINS bank

 CBA
CREDIT BANK OF ALBANIA
BANKA E KREDITIT TE SHQIPERISE

 Emporiki Bank
CREDIT AGRICOLE GROUP

 Fibank
First Investment Bank

 Banka Nderkombetare Tregtare
International Commercial Bank

 INTESA SANPAOLO BANK
Albania

 NBG Bank

 ProCredit Bank

 Raiffeisen
BANK

 SOCIETE GENERALE
ALBANIA

 TIRANA
BANK

 UNION
BANK

 UBA
United Bank
of Albania
Banka e Bashkuar
e Shqiperise

 VENETO BANKA
GRUPPO VENETO BANCA

■ www.aab.al

Përmbajtja

EDITORIAL

Besimi në bankingun klasik nga *Elvin Meka*

f.5

TEMA E DITËS

Sektori bankar në Shqipëri është i fortë dhe do të vazhdojë të mbetet i tillë nga *Klodian Tomorri*

f.7

Konservatorizimi i bankave: Zgjedhje e qëllimshme apo e detyruar prej ngjarjeve? nga *Arjan Kadare*

f.8

INTERVISTA

Menaxhimi i aktiveve - Fillimi i një epoke të re në sistemin financiar shqiptar
Intervistë me Z. Christian Canacaris

f.9

SISTEMI BANKAR

Ekzekutimi i detyrueshëm: Efektiviteti i tij, shtysë për ekonominë e tregut nga *Erion Doko*

f.11

Ligji i ri për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe ndikimi i pritshëm në praktikën bankare të huadhënies nga *Veronika Prifti*

f.14

Konkurrenca në tregun e bonove të thesarit nga *Klodian Tomorri*

f.17

FORUMI I EKSPERTËVE

Transparenca e kontratave bankare - një këndvështrim ligjor nga *Ledia Plaku*

f.19

Grabitja e bankave dhe ruajtja e vendit të ngjarjes nga *Roland Tashi*

f.23

KËNDI I EKONOMISTIT

Reformimi i bankave - përgjigje e duhur ndaj krizës nga *Adrian Civici*

f.26

PËRGJEGJSHMËRIA SOCIALE

RRJETI BALLKANIK

Lajme ndërballkanike

f.32

TEKNOLOGJI

Pagesat me celular - metodë alternative pagesash nga *Linda Shomo*

f.36

AUDITORI FINANCIAR

Financimi i projekteve nga *Junida Tafaj*

f.38

AAB

f.41



BANKIERI është publikimi më i ri zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili do t'i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. BANKIERI do t'i japë lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arrijet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

Bankieri

Nr. 3, Prill 2012

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave

Ekipi Editorial:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Klodian Tomorri

Bashkëpunëtor

Junida Katroshi (Tafaj)

Koordinatorë Produksioni

Sonila Krashi

Design & Layout

Besa Vila

Redaktore

Gert Hoxha

Fotograf

Bordi Editorial:

Seyhan PENCABLIGIL

Kryetar i AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm,
Banka Kombëtare Tregtare

Ioannis KOUGIONAS

Nënkryetar i AAB - së & Drejtor i Përgjithshëm,
NBG Bank

Christian CANACARIS

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së &
Drejtor i Përgjithshëm, Raiffeisen Bank

Flutura VEIPI

Anëtare e Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtuese e
Drejtorisë Ekzekutive, Procredit Bank

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i
Përgjithshëm Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri

Endrita XHAFERAJ

Sekretare e Përgjithshme
Shoqata Shqiptare e Bankave

Hysen CELA

Drejtor Ekzekutiv, Instituti i Ekspertëve Kontabël të
Autorizuar të Shqipërisë

Adrian CIVICI

Anëtar, Shkolla Doktorale
Universiteti European i Tiranës

Spiro BRUMBULLI

Rektor - Tirana Business University

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", KULLAT BINJAKE

Kulla I, Kati 6-të, A3, Tiranë

Tel: +355 4 2280 371; Fax: +355 4 2280 359

E-mail: bankieri@aab-al.org; www.aab.al

Maksimizoni me zgjuarsi përfitimet tuaja

Zgjuarsi është të keni një llogari kursimi me shumë avantazhe, e cila shton në maksimum përfitimet tuaja.

Alpha **SMART** është një llogari e zgjuar, e cila kombinon normë interesi të lartë deri në 4.6% në Lek dhe mundësi për t'i përdorur paratë tuaja në çdo moment.

Për më tepër, një paketë analizash mjekësore falas.*

Hapni tani një llogari kursimi Alpha **SMART** dhe maksimizoni me zgjuarsi përfitimet tuaja!



ALPHA SMART

*Për klientët që kanë balancë më shumë se 5.000 Euro ose ekuivalent Lek për 6 muaj



ALPHA BANK

BESIMI NË BANKINGUN KLASIK!



nga Dr. Elvin MEKA
Kryeredaktor

Sistemi bankar shqiptar, i mbështetur në themelin e fortë të modelit klasik, jo vetëm e kaloi provën me sukses, por po ecën mbi baza të shëndosha drejt zgjerimit dhe modernizimit, duke mbështetur në çdo moment e në mënyrë të qëndrueshme, përparimin e ekonomisë së Shqipërisë.

Lajmet e kohëve të fundit në të gjithë mediat raportojnë në kufijtë e habitës, tre fakte të rëndësishme mbi aktivitetin e bankave në Shqipëri: rritje të dukshme të depozitave, rritje në vijim të huave me probleme dhe rritje të rëndësishme të fitimeve për të gjithë sistemin bankar. Të marra të tre së bashku duket sikur përballemi me një paradoks, por të vendosura në kontekstin e sistemit bankar shqiptar kjo nuk ka pse dhe nuk habit askënd. Kjo pasi përgjigja është vetshpjeguese, në dy drejtime: (1) bankat në Shqipëri ndjekin një model biznesi të bankingut tradicional dhe (2) vendosja e këtij bankingu në një mjedis rregullator konservator, i mbikëqyrur me rigorozitet dhe vijueshmëri shembullore nga Banka e Shqipërisë.

Ishte pikërisht ky model tradicional bankingu që, jo vetëm mundësoi absorbimin e të gjithë goditjeve të formave të ndryshme e në kohë të ndryshme të krizës globale ekonomike e financiare, por e vendosi sistemin bankar shqiptar në hollin e famës së besimit të publikut të gjerë, gjë kjo tepër e rrallë dhe e çmuar, veçanërisht në kohët që po kalojmë. Rritja e pandalshme e depozitave, që nga viti 2009, pavarësisht nga moria e ngjarjeve financiare rajonale e globale, kapitalizimi i qëndrueshëm i bankave, likuiditeti i kënaqshëm, zgjerimi i huadhënies dhe fitimi pozitiv gjithnjë në rritje, dëshmojnë për drejtësinë dhe qëndrueshmërinë e modelit të zgjedhur nga bankat në Shqipëri. Modeli tradicional i bankingut, i mbështetur në

dy parime të forta: (1) sigurimi i një strukture të thjeshtë financimi, nëpërmjet depozitave të klientëve e me një përdorim të moderuar të levës financiare, dhe (2) ofrimi i produkteve dhe shërbimeve klasike, larg produkteve të sofistikuarra e që gjeneruan krizën, rezultoi të ishte modeli më i qëndrueshëm ndaj krizës, më efektiv në menaxhim dhe më i përshtatshëm për fazën e zhvillimit aktual ekonomik dhe social të Shqipërisë.

Sigurisht, sfida mbetet menaxhimi i huave me probleme dhe kthimi i tyre në vlerën njëshifrore, por kjo nuk është një tango që kërcëhet me dy vetë, bankat dhe klientët e tyre. Menaxhimi i bankingut, qoftë ky tradicional ose modern, mbaron aty ku fillon përgjegjësia e institucioneve të drejtësisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit.

Natyrisht, kriza e fundit globale ekonomiko-financiare do të ridimensionojë jo vetëm sistemin bankar global, por dhe sistemin financiar global, duke e rikthyer atë me këmbë në tokë. Sistemi bankar shqiptar, i mbështetur në themelin e fortë të modelit klasik, jo vetëm e kaloi provën me sukses, por po ecën mbi baza të shëndosha drejt zgjerimit dhe modernizimit, duke mbështetur në çdo moment e në mënyrë të qëndrueshme, përparimin e ekonomisë së Shqipërisë. Tashmë gjithkush prej nesh mund të ndihet mirë dhe të pohojë fort:

KEMI BESIM TEK BANKINGU KLASIK SHQIPTAR!!!

SEKTORI BANKAR NË SHQIPËRI është i fortë dhe do të vazhdojë të mbetet i tillë

Bankat shqiptare kanë qëndruar larg aktiveve me rrezik të lartë, të ashtuquajtura aktive toksike, të cilat ishin dhe zanafilla e krizës së sistemit financiar në SHBA, që më pas u përhap në gjithë botën.

Efektet e krizës në ekonominë shqiptare kanë qenë shpesh objekt i nxehtë debati gjatë tre viteve të fundit. Por ekspertët bashkohen të gjithë në një pikë, atë që vendi ka një sistem bankar solid, i cili e përballoi me sukses krizën. "Gjatë kësaj kohe pyetja më e shpeshtë që shumë njerëz më bënë ka qenë: A është sektori bankar në Shqipëri i fortë? Përgjigja është pa asnjë dyshim po," thotë Dr. Ioannis Kougionas, nënkryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave. Dr. Kougionas thotë se fakti që sistemi bankar në Shqipëri i rezistoi me sukses krizës nuk është i rastësishëm. Gjatë një aktiviteti shkencor me temë: "Kriza Ekonomike Evropiane dhe pasojat në periferinë e saj", të mbajtur në Tiranë, ai liston disa arsye që i mbajtën bankat shqiptare larg krizës. "Së pari dhe mbi të gjitha sektori bankar në Shqipëri është likuid dhe i mirëkapitalizuar. Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit që është treguesi kryesor që mat se sa i kapitalizuar është një sistem bankar, në Shqipëri është aktualisht 15.6 për qind, kur në shumicën e vendeve të botës ai luhet nga 8 deri në 10 për qind" - sqaron ai. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit u përmirësua nga 15.4 për qind në fund të 2010-ës në 15.6 për qind. Por jo vetëm kaq. Bankat janë likuide dhe të mirërregulluara. "Aktualisht ka një kuadër të gjerë rregullator sa i takon likuiditetit dhe menaxhimit të riskut. Vitin e fundit ka patur disa ndryshime të reja në ligjin për bankat, të cilat kanë forcuar edhe më shumë mbrojtjen e sistemit, çka është shumë e rëndësishme" - vijon Dr. Kougionas. Bankat shqiptare kanë qëndruar larg aktiveve me rrezik të lartë, të ashtuquajtura aktive toksike, të cilat ishin dhe zanafilla e krizës së sistemit financiar në SHBA, që më

pas u përhap në gjithë botën. Aktiviteti i bankave në Shqipëri ka qenë i përqëndruar kryesisht tek bankingu tradicional, larg instrumenteve të rrezikshëm, që gjeneruan krizën. "Faktorëve të mësipërm do t'u shtoja dhe një tjetër që është shumë i rëndësishëm. Një tjetër pikë e fortë është bashkëpunimi i mirë mes palëve të përfshira si: Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave dhe vetë bankat mes njëra - tjetrës," - sqaron Dr. Kougionas.



Aktiviteti i bankave në Shqipëri ka qenë i përqëndruar kryesisht tek bankingu tradicional, larg instrumenteve të rrezikshëm, që gjeneruan krizën.

*Dr. Ioannis KOUGIONAS
Drejtor i Përgjithshëm, NBG Bank*

Rritja e pandërprerë

Gjatë dhjetë viteve të fundit, sektori bankar në Shqipëri ka vazhduar të zgjerojë aktivitetin me ritme të larta. Sot aktivet e bankave përbëjnë rreth 95 për qind të aktiveve totale financiare në Shqipëri. "Është e rëndësishme të themi se rritja e aktiveve në sektorin bankar ka ardhur kryesisht nga burimet e brendshme. Depozitat për-

bëjnë sot rreth 80 për qind të aseteve totale të sektorit bankar," - vijon Dr. Kougionas. "Sigurisht ka patur një ngadalësim të kreditimit në dy vitet e fundit, por duhet theksuar se sërish prirja është pozitive dhe kredia vazhdon të rritet," - vëren Dr. Kougionas. Gjithashtu, sektori bankar ka një rol të rëndësishëm edhe në ofrimin e risive. "Produkte dhe shërbime të reja kanë hyrë në tregun financiar si financimi i projekteve, kreditë hipotekore, kreditë konsumatore, bankingu elektronik, lizingu etj," - thotë Dr. Kougionas.

Ekzekutimi i kolateralit – çështja në rend të ditës

Tre vitet e fundit kanë qenë të trazuar për sistemin financiar në mbarë botën. Kjo situatë ka nxjerrë në pah edhe disa çështje për sistemin bankar në Shqipëri, ku një nga më të rëndësishmet është rritja e kredive me probleme, që publiku tashmë e ka të njohur. "Të gjitha bankat kanë fonde të mjaftueshme rezervë për të amortizuar ndikimet e rritjes së huave me probleme. Gjithashtu bankat po zbatojnë standarde më të kujdeshme në kreditim," thotë ai. Ekspertët thonë se është e domosdoshme që vendi të mbajë një sektor bankar të shëndetshëm, sepse bankat janë të detyruara të mbrojnë paratë e klientëve të tyre. "Në këtë pikë është e rëndësishme ekzekutimi i kolateraleve, dhe kjo është një tjetër çështje me të cilën ne përballlemi," - thotë Dr. Kougionas - "ndonëse përmbartimi privat e ka përmirësuar situatën". Megjithatë, ai mbetet i bindur se sektori bankar në Shqipëri është i ndërtuar mbi baza të shëndosha. "Siç e thashë, sektori bankar në Shqipëri është i fortë dhe do vazhdojë të mbetet i tillë," - përfundon Dr. Kougionas.

përgatiti Klodian TOMORRI

KONSERVATORIZMI I BANKAVE: Zgjedhje e qëllimshme apo e detyruar prej ngjarjeve?



nga Arjan KADARE, PhD
Universiteti European i Tiranës

Pavarësisht rënies së bankës Lehman Brothers dhe pasojave që u ndjenë në Europë, tërheqjet e depozitave bankare në tremujorin e katërt të vitit 2008 në Shqipëri ishin paksa surprizuese. Në fund të fundit, sistemi bankar ishte plot energji dhe në formë shumë të mirë, me rritje të qëndrueshme të aktiveve, huave dhe depozitave, dhe me një tregues të ndjeshëm kthimi nga aktivet mbi nivelin e konsiderueshëm prej 1 për qind. Ecuria e përgjithshme e ekonomisë ishte gjithashtu e mirë, me një normë rritjeje mbi 6 për qind dhe me nivele nën kontroll të borxhit të qeverisë dhe deficitit.

Ja ku jemi pas tre vjetësh, dhe paniku tashmë është histori e shkuar. Në vitin 2011, depozitat bankare dhe huatë u rritën me ritme dyshifrore, treguesi i kthimit nga aktivet pritet të arrijë nivelet para vitit 2009, dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është rreth 3 për qind më i lartë se norma minimale prej 12 për qind e kërkuar nga Banka Qendrore. I vetmi problem shqetësues është raporti në rritje i huave me probleme kundrejt totalit të huave të dhëna nga bankat.

Një dekadë më parë

Sistemi bankar privat në Shqipëri ishte relativisht i ri. Ai ishte krijuar pothuajse më shumë se një dekadë më parë nëpërmjet licencimit të

degëve dhe filialeve të bankave të huaja, privatizimit të bankave të vjetra shtetërore dhe blerjes së bankave të reja nga të huajt. Aktorët kryesorë në privatizim dhe në blerje ishin grupe bankare europiane të mirënjohura.

Në atë kohë njerëzit ishin të vetëdijshëm se pas privatizimit / liberalizimit të sistemit bankar dhe liberalizimit të lëvizjes së kapitalit, duhej të pritej një bum i rritjes së huave. Në raste të ngjashme, rritje të tilla kanë qenë të zakonshme në vende të tjera në zhvillim, dhe për fat të keq në shumë raste, për shkak të mungesës së ekspertizës në kontrollin dhe në monitorimin e huamarrësve, dhe të një mbikëqyrjeje të dobët nga rregullatorët bankarë, kanë çuar në humbje të mëdha, e deri edhe në kriza bankare. Kështu, kriza e Meksikës në vitin 1994 dhe ajo e Azisë Lindore në vitet 1997 - 98 u paraprinë nga liberalizimi i sistemit bankar dhe i lëvizjes së kapitalit.

Në të vërtetë, siç mund të shihet në Grafikon 1, vijoi një rritje e qëndrueshme në raportin e huave mbi depozitat e bankave, nga 22 për qind në vitin 2006 në rreth 60 për qind në


vitin 2011. Pra, rreziku i ndërmarrë nga sistemi bankar, i përfaqësuar nga ky raport i huave ndaj depozitave, po rritej gradualisht. Megjithatë, edhe në vitin 2009 kur ky raport arriti nivelin e vet më të lartë prej 65 për qind, kishte mjaftueshëm depozita bankare për të mbështetur huatë në mënyrë të sigurt.

Dy ngjarje paralajmëruese dhe konservatorizmi i bankave

Dy ngjarje pothuajse të njëkohshme ishin shenja paralajmëruese për sistemin bankar: tërheqja e depozitave duke filluar nga tremujori i katërt i vitit 2008 deri rreth mesit të vitit 2009 dhe rritja e shpejtë e huave me probleme, të cilat pothuajse u dyfishuan në vitin 2008. Bankat reagues duke ngadalësuar menjëherë huadhënien dhe raporti i huave ndaj depozitave ra nga 65 për qind në vitin 2009 në 58 për qind në vitin 2010. Rënia në ritmin e kredidhënies bëhet edhe më e thellë po të kemi parasysh që në vitin 2009 depozitat u pakësuan në terma absolutë.

Megjithatë, ndërsa ndodhnin këto ngjarje, sistemi kishte marrë përsipër

Grafik 1



më pak rrezik sesa kishte mundësi të përballonte, sepse po kreditonte sektorin privat me rreth vetëm 60 për qind të depozitave bankare. Gjithsesi, shifra e agreguar abstragon nga fakti që bankat e mëdha po jepnin hua vetëm 40 për qind të depozitave të tyre, ndërsa pjesa tjetër e bankave të sistemeve shumë më tepër, me shumë gjasa për të fituar pjesë të tregut. Ndaj, bankat e mëdha më konservatore ishin në gjendje shumë më të përshtatshme për të përballuar ngjarjet. Mbetet gjithsesi një pyetje: cili është ritmi i duhur (konservator) i marrjes përsipër të rrezikut? Në përgjithësi, ai duhet të përshtatet me ritmin e potencialit të sektorëve të ekonomisë për të përthithur hua. Duhet theksuar, megjithatë, se potenciali për përthithje kredie nuk përkon domosdoshmërisht me potencialin për rritje të sektorit. Le të marrim në konsideratë sektorin e bujqësisë që është konsideruar si sektori me potencial më të madh zhvillimi. Në vitin 2011, ky sektor përfitoi vetëm 2-3 për qind të huasë bankare, ndërsa raporti i huave me probleme ndaj totalit të huave dhënë këtij sektori ishte 18.6 për qind. Treguesi i huave me probleme ndaj totalit të huave dëshmon qartë se përthithja e huasë nga ky sektor është ndjeshëm më poshtë se potenciali i tij për zhvillim.

Huatë me probleme dhe ekonomitë e shkallës


Ia vlen të shpjegojmë edhe disa fakte të tjera. Për periudhën nga viti 2005 - 2011, sipas Raporteve Vjetore të Mbikëqyrjes 2006 - 2010, të Bankës së Shqipërisë, kthimi nga aktivet mesatare (RoAA) arriti edhe nivele më të ulëta sesa niveli 1 për qind gjatë vitit 2009 dhe 2010, kur huatë me probleme arritën dhe tejkaluan një të dhjetën e totalit të huave të dhëna nga bankat.

Megjithatë, pritet që mesatarisht RoAA e sistemit bankar të ketë ndryshuar drejtim për më mirë në vitin 2011 (shih grafikun 2). Mund të thuhet gjithashtu se, edhe pse huatë me probleme arritën 18.8% në fund të vitit 2011, fitimet e sistemit duket se janë mëse të mjaftueshme për t'u lejuar bankave zgjerimin e fondeve të provigjionimit për këto hua me probleme, si një masë mbrojtëse dhe konservatore e kërkuar nga Banka e Shqipërisë.

Shumica e bankave në Shqipëri janë filiale të grupeve bankare europiane, prej të cilave kanë marrë modelet dhe praktikat më të mira të


Dy ngjarje pothuajse të njëkohshme ishin shenja paralajmëruese për sistemin bankar: tërheqja e depozitave duke filluar nga tremujori i katërt i vitit 2008 deri rreth mesit të vitit 2009 dhe rritja e shpejtë e huave me probleme, të cilat pothuajse u dyfishuan në vitin 2008.

Grafik 2



(Burimi i të dhënave: Banka e Shqipërisë)

Grafik 3



(Burimi i të dhënave: Shoqata Shqiptare e Bankave)

biznesit. Megjithatë, për të shfrytëzuar plotësisht ekonomitë e shkallës, ato duhet të rrisin pjesën e tyre të tregut edhe në Shqipëri. "Arsyeja" për këtë shpjegohet më mirë në Grafikun 3, ku sipas të dhënave të paaudituar të Shoqatës Shqiptare të Bankave, bankat më të mëdha (të identifikuara kështu në bazë të pjesës që zënë në totalin e aktiveve të sistemit bankar) patën një ecuri relativisht më të mirë për sa i përket kthimit nga aktivet dhe si pasojë e përballuan më mirë

situatën e vështirë të rritjes së huave me probleme.

Pra, ndoshta konservatorizmi ishte një zgjedhje e qëllimshme, të paktën për bankat e mëdha, ose ndoshta ishte zgjedhje e detyruar prej ngjarjeve, të paktën për bankat e vogla, ose ndoshta të dyja bashkë. Sido që të jetë, mund të thuhet se sistemi bankar shqiptar e ka kaluar pa dëme të mëdha provën e parë të vështirë të ekzistencës së vet.

MENAXHIMI I AKTIVEVE

Fillimi i një epoke të re në sistemin financiar shqiptar

Prezantimi i RAIFFEISEN INVEST si shoqëri e menaxhimit të aktiveve shënon një hap të rëndësishëm përpara në zhvillimin e sistemit financiar shqiptar dhe në vetë ndërmjetësimin financiar.

BANKIERI: – PAK JAVË MË PARË JU PREZANTUAT SHOQËRINË E PARË TË MENAXHIMIT TË AKTIVEVE NË SHQIPËRI, RAIFFEISEN INVEST. CILI ËSHTË QËLLIMI I KËSAJ SHOQËRIE?

Kjo është një shoqëri që do të merret me menaxhimin e aktiveve dhe që u ofron individëve një mundësi investimi në fonde të investimit kolektiv. Në fokus të veprimtarisë së saj do të jetë sigurimi i fondeve në monedhë vendase dhe të huaj. Ne ofrojmë gjithashtu edhe një fond pensioni për klientët individualë dhe institucionalë. Klientët mund të marrin më shumë informacion mbi ofertat e fondit të pensionit dhe të fondit të investimit të RAIFFEISEN INVEST në secilën nga 103 degët dhe agjencitë e Raiffeisen Bank në të gjithë vendin. Gjithashtu, ata mund të telefonojnë në qendrën tonë telefonike, për informacion paraprak, përpara se të vizitojnë njërën nga degët ose të flasin me menaxherin e llogarive të tyre.

BANKIERI: – JU GJITHASHTU PREZANTUAT RAIFFEISEN PRESTIGE - FONDIN E PARË TË INVESTIMEVE NË SHQIPËRI – SI PJESË E RAIFFEISEN INVEST. ÇFARË RISIE SJELL KY FOND NË TREGUN FINANCIAR SHQIPTAR?

Ne ua ofrojmë këtë fond investimesh si klientëve tanë ekzistues, ashtu edhe çdo klienti të ri. Ky fond u siguron klientëve tanë një mundësi alternative e të leverdishme investimi për kursimet e tyre, të ndryshme nga depozitat me afat ose depozitat e kursimit. Fondi ynë i investimeve i lejon ata të marrin pjesë në investimet në letra me vlerë të qeverisë shqiptare me një shumë investimi të arsyeshme e të vogël.

Edhe me vetëm 5.000 Lekë klientët mund të investojnë në letrat me vlerë të qeverisë. Përndryshe, nëpërmjet kanaleve të tjera, për këtë lloj investimi nevojitet një shumë minimale, që është shumë më e lartë. Ne duam t'i japim klientit tonë mundësinë për të investuar një shumë të vogël dhe për të pasur një kthim të mirë.

Ne kemi filluar me PRESTIGE, që është një fond për letrat me vlerë të qeverisë në Lekë, dhe me kalimin e kohës do të prezantojmë edhe fonde të tjera, duke filluar më vonë, gjatë këtij viti, me një fond në monedhë të huaj.

BANKIERI: – FONDET E INVESTIMEVE KANË NJË SHTRIRJE TË GJERË AKTIVITETI BIZNESI, PASI ATO OFROJNË NJË GAMË TË GJERË PRODUKTESH DHE SHËRBIMESH FINANCIARE. KONKRETISHT, KU DO TË FOKUSOHET MË SË SHUMI AKTIVITETI I RAIFFEISEN PRESTIGE?

Fondi PRESTIGE do të investojë kryesisht në letra me vlerë të qeverisë (Bono të Thesarit dhe Obligacione). Këto janë produkte investimi me të cilat shumë konsumatorë janë tashmë të njohur dhe të cilat ofrojnë në përgjithësi normë të mirë fitimi.



*Christian CANACARIS
Drejtor i Përgjithshëm, Raiffeisen Bank*

BANKIERI: – AKTUALISHT INDIVIDËT MUND TË INVESTOJNË NË LETRAT ME VLERË TË QEVERISË NËPËRMJET KANALEVE TREGTARE TRADICIONALE, SI BANKAT TREGTARE DHE NËPËRMJET SPORTELET TË BONOVE TË THESARIT NË BANKËN E SHQIPËRISË. CILA ËSHTË PËRPARËSIA QË SJELL KY FOND INVESTIMI PËR INVESTUESIN SHQIPTAR?

Lehtësia e hyrjes. Për momentin, një individ do t'i duhej një shumë parash shumë më e madhe sesa 5.000 Lekë, nëse do të donte të blinte një bono thesari. Kjo do të thotë që bonot e thesarit nuk janë të arritshme për investim nga të gjithë klientët.

BANKIERI: – A MUND TË SHIHET KRIJIMI I KËTJË FONDIT SI NJË MËNYRË PËR TË LEHTËSUAR APO AMORTIZUAR KUFIZIMET MË TË FUNDIT VENDOSUR NGA BASHKIMI EUROPIAN MBI BANKAT PRIVATE, BRENDA KUADRIT TË SISTEMIT FINANCIAR SHQIPTAR?

Nisma jonë për hedhjen në treg të fondit nuk ka aspak të bëjë me rregulloret e reja të Autoritetit Bankar Europian (EBA). Ne kemi dashur të krijojmë një linjë fondesh qysh 2 vjet më parë, me qëllim që t'u japim një tjetër mundësi investimi klientëve tanë. Një fond për letra me vlerë të qeverisë është menduar gjithmonë si hap fillestar. Për krijimin e një tregu hapi i parë shumë i logjikshëm është një fond i tregut të parasë në monedhë kombëtare, me fokus te letrat me vlerë të qeverisë. Është thjesht koincidencë që momenti i prezantimit të këtij fondi në treg përkoj me rregulloret e reja të EBA-s. Siç e përmenda më sipër, ne do të vijojmë me planet tona të zhvillimit, me hapin tjetër për krijimin e fondeve në monedhë të huaj, në mënyrë të pavarur nga kufizimet nga EBA ose BE-ja.



Nga **The Banker**

Falë jush, jemi Banka Më e Mirë
në Shqipëri për herë të 4t.



Sërish BANKA MË E MIRË NË SHQIPËRI PËR VITIN 2011

4 22 66 288 | www.bkt.com.al

EKZEKUTIMI I DETYRUESHËM: Efektiviteti i tij, shtysë për ekonominë e tregut



nga Erion DOKO
Drejtor i Departamentit Ligjor
Banka e Parë e Investimeve
Shqipëri

Nevojiten ndryshime të mëtejshme në Kodin e Procedurës Civile si edhe unifikimi i praktikës së ndjekur. Rifreskimi i kësaj kornize ligjore kërkon një angazhim minimal nga institucionet ligjvënëse si Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi i Shqipërisë, dhe do të ketë një kontribut dhe ndikim të qenësishëm në zhvillimin ekonomik.

Gjatë 20 viteve të fundit Shqipëria ka vijuar përpjekjet për zhvillimin e ekonomisë së tregut. Që kjo ekonomi të funksionojë, në mënyrën sa më efektive të mundshme, nevojitet një qarkullim i shpejtë e i lirë i parasë. Kjo është e mundur në një sistem ku garantohej shlyerja e detyrimeve brenda një kohe të arsyeshme. Mbështetur në këtë ide, legjislacioni shqiptar ka pasur së fundmi zhvillim të konsiderueshëm ku vlen të theksohet liberalizimi i shërbimit përmbarrimor si edhe disa ndryshime të kryera në Kodin e Procedurës Civile, por megjithatë disa problematika që presin zgjidhje vijojnë të përbëjnë pengesë për qarkullimin e lirë të parasë në ekonominë shqiptare dhe për zhvillimin e një klime të favorshme biznesi. Efektiviteti i procesit të ekzekutimit të detyrueshëm dhe mbledhja e detyrimeve në një kohë sa më të shkurtër do të sillte për pasojë likuiditet të ri në ekonomi, i cili brenda një kohe të shkurtër do të krijonte vende pune të reja, do të rriste konsumin, pra edhe rritje të ekonomisë.

Pa dyshim që një nga pengesat kryesore për një zhvillim të qëndrue-

shëm të ekonomisë dhe të rritjes së huadhënies në Shqipëri është pamundësia e ekzekutimit të kolateralit në mënyrë efikase, brenda një kohe të arsyeshme dhe brenda kufijve të pranueshëm juridikë dhe ekonomikë.

Bankat tregtare, si huadhënësit më të mëdhenj të ekonomisë, me mbështetjen e plotë të Bankës së Shqipërisë, kanë ngritur në mënyrë të vazhdueshme shqetësimet e tyre në lidhje me problematikën që hasin gjatë procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm të kolateraleve. Një kontribut të rëndësishëm në ngritjen e problematikës që lidhet me këtë temë ka luajtur Shoqata Shqiptare e Bankave, duke parashtruar pengesat dhe vështirësitë e natyrës ligjore dhe burokratike në një sërë tryezash të organizuara prej saj.

Sidoqoftë, pas rreth një viti përpjekjesh shumëpalëshe për zgjidhjen më të mirë të këtyre problematikave, duke pasur në fokus edhe shqetësimin e rritjes së treguesit të huave me probleme që është sot një çështje e ditës, ia vlen të përmendim e ritheksojmë çështjet që presin ende përgjigje.

Mënyra e llogaritjes dhe pagesa e tarifave për subjektet përmbarrimore private

Një nga qëllimet e ligjit nr. 10031, datë 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat" ka qenë ai i liberalizimit të shërbimit përmbarrimor duke ofruar zbatim të shpejtë dhe efikas të vendimeve të gjyqësorit. Gjithsesi, mënyra e llogaritjes dhe pagesa e tarifave për subjektet përmbarrimore private e zbeh qëllimin e ligjit dhe cenon konkurrencën.

Kontrata Model, e miratuar nga Ministria e Drejtësisë parashikon ndër të tjera që: "Tarifa e plotë e shërbimit paguhet në momentin e kalimit në ekzekutim të detyrueshëm". Mbi këtë bazë, përmbarruesit privatë pretendojnë se pagesa e tarifës së plotë të shërbimit duhet të kryhet në momentin e fillimit të ekzekutimit të detyrueshëm. Në këtë fazë, vlen të theksohet se ende nuk rezultojnë të jetë ekzekutuar ndonjë pjesë e detyrimit në favor të kreditorit. Tarifa e plotë e shërbimit përmbarrimor llogaritet në bazë të vlerës së padisë, pra të shumës së detyrimit të kërkuar nga kreditori në momentin e fillimit të pro-



cedurave të ekzekutimit të detyrueshëm. Kjo mënyrë llogaritjeje dhe pagese nuk i përgjigjet interesave të palëve të përfshira në proces, duke prodhuar jo vetëm mungesë efektiviteti, por dhe abuzim.

Së pari, nga këndvështrimi i kreditorit kjo mënyrë llogaritjeje dhe pagese rrit në mënyrë të padrejtë shpenzimet e kreditorit, duke rritur njëkohësisht dhe detyrimet e debitorit. Në momentin e kalimit në ekzekutim të detyrueshëm ka një shkallë të lartë pasigurie lidhur me masën dhe me momentin e mbledhjes pjesërisht ose plotësisht të shumës së detyrimit. Fatkeqësisht, rastet e pamundësisë së ekzekutimi të kolateralit, ose ek-

Një zgjidhje e pranueshme për të gjitha palët mund të ishte përcaktimi i kamatës ligjore, e cila do të mund të zbatohet e të llogaritet pas momentit të lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit.

zekutimit të pjesshëm të tij nuk janë vetëm raste teorike. Në raste të tilla, kreditori gjendet përballë një situatë të papëlqyer, ku përveç mungesës së likuiditetit nga pamundësia e përm-bushjes së detyrimit të debitorit (plotësisht, ose pjesërisht) bankat kanë regjistruar dhe shpenzime përmbare ekstra të cilat duke mos përm-bushur qëllimin e tyre kanë rezultuar të panevojshme.

Së dyti, nga këndvështrimi i debitorit, duke pasur parasysh se ky shpenzim i ngarkohet në përfundim të procedurës së ekzekutimit, kjo mënyrë llogaritjeje dhe pagese mund të interpretohet si e padrejtë. Duke iu referuar përsëri rasteve të pamundësisë së ekzekutimit, ose ekzekutimit të pjesshëm të tij, detyrimet e debitorit rriten në mënyrë artificiale me tarifën e përmbaremit. Kjo rritje artificiale e detyrimit të debitorit mund të konsiderohet lehtësisht abuzive.

Së treti, për subjektet përmbaremore kjo mënyrë llogaritjeje dhe pagese e tarifës përmbaremore nuk i shërben konkurrencës dhe rritjes së efektivitetit. Është e qartë prirja e subjekteve private, sado të ndërgjegjshëm të jenë, që duke arkëtuar tarifën e plotë të shërbimit që në momentin e parë do të humbitnin motivimin për të ofruar në mënyrën më të mirë shërbimin e kërkuar. Nëse do të ruhej motivimi i tyre duke aplikuar dhe duke llogaritur tarifën e shërbimit në proporcion me shumën e mbledhura nga ekzekutimi, përmbaremit do të ishin dhe më të interesuar të investonin në

Gjykohet shumë i domosdoshëm amendimi i mënyrës së llogaritjes dhe pagesës së tarifës së përmbaremit private, ku përcaktimi i tarifave tavan dhe pagesa në proporcion me detyrimin e mbledhur do të ishte zgjidhja korrekte për të gjitha palët.

kapacitete logjistike ose në zhvillimin e kapaciteteve intelektuale dhe profesionale.

Gjithashtu, Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë që cakton tarifën për shërbimet nga subjektet përmbaremore private vijon të ruajë të njëjtën frymë si më parë, duke caktuar tarifa fikse. Me qëllim nxitjen e konkurrencës, uljen e kostove të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore dhe mbi të gjitha, ruajtjen e interesave të debitorit, shohim si zgjidhje amendimin e këtij Udhëzimi duke parashikuar tarifa tavan për çdo shërbim, përpos pagesës së një shume në proporcion me detyrimin e mbledhur nga ana e përmbaremit. Në këtë mënyrë kreditori dhe debitori do të ishin në gjendje të negocionin vetë tarifën e shërbimit të ofruar, gjithmonë pa kaluar atë tavan të vendosur nëpërmjet Udhëzimit.

Zgjatja e afateve të gjyqimit

Siç është theksuar edhe më parë, një aspekt problematik për ekzekutimin e kolateralit janë vonesat e shkaktuara nga zgjatja e afateve të gjyqimeve, çka ndodh shpesh si pasojë e marrjes së masave të pezullimit të veprimeve përmbaremore, kryesisht gjatë gjyqimit në Shkallë të Parë. Duke pranuar si tepër pozitiv faktin e ndryshimeve të fundit të Kodit të Procedurës Civile, lidhur me afatet e shqyrtimit të ankimeve kundër veprimeve të përmbaremit gjyqësor, gjykojmë se nevojitet plotësimi i dispozitave të Kodit të Procedurës Civile për Gjykatën e Apelit, duke i vendosur kësaj të fun-

dit detyrimin për shqyrtimin brenda një afati të arsyeshëm të ankimeve kundër veprimeve gjyqësore. Kështu, do të shmangeshin një sërë ankimesh abuzuese të debitorëve, me synim mbajtjen sa më gjatë të një mase pezullimi, gjatë shqyrtimit të ankimit nga Gjykata e Shkallës së Parë. Është për t'u theksuar edhe fakti se Gjykata e Shkallës së Parë, në shumë raste tejkalon afatet e parashikuara në ligj, çka është një nga shkaqet kryesore të zgjatjes së afateve të gjykimit dhe të pamundësisë së bankave për të ekzekutuar kolateralin brenda një kohe të arsyeshme.

Llogaritja e interesave dhe e penaliteteve pas datës së lëshimit të Urdhrit të Ekzekutimit.

Një zgjidhje përfundimtare, të qartë dhe të unifikuar, në legjislacionin aktual, nuk gjen as problemi i llogaritjes së interesave dhe penaliteteve, pas lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit nga Gjykatat, deri në momentin e ekzekutimit të plotë të detyrimit. Kuptohet që, vijimi i llogaritjes së interesave dhe penaliteteve edhe pas lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit dhe

për të gjithë periudhën e nevojshme të ekzekutimit të detyrueshëm, ka për qëllim sigurimin e ekuilibrit të nevojshëm si dhe garantimin e kurtimeve të depozituesve. Së pari, përllogaritja e interesave dhe penaliteteve e bën çdo debitor të mundohet të paguajë detyrimet sa më parë, në mënyrë që këto detyrime të mos shtohen akoma më shumë. Së dyti, kreditori (banka) që përballohet me mungesën e likuiditetit dhe kryerjen e shpenzimeve shtesë, do t'i përdorte këto interesa në radhë të parë për pagesën e interesave ndaj depozituesve të tij. Mosllogaritja e interesave dhe penaliteteve shkon në kundërshtim me normat mbi të cilat funksionon ekonomia e tregut.

Një zgjidhje e pranueshme për të gjitha palët mund të ishte përcaktimi i kamatës ligjore, e cila do të mund të zbatohet e të llogaritet pas momentit të lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit. Në mungesë të kamatës ligjore, huadhënësit janë të detyruar të vijojnë të përllogarisin interesat dhe penalitetet sipas parashikimeve të Kontratës së Kredisë.

kredia bankare...

duhet të konsiderohet si një marrëdhënie krejt e ndryshme në aspektin juridik nga ajo e zakonshmja ndërmjet dy individëve, ose personave të ndryshëm juridikë.

Përjasja jo e drejtë e Gjykatave gjatë procesit të ekzekutimit të detyrueshëm

Kjo problematikë e ka origjinën, më së shumti, në eksperiencën e shkurtër të grumbulluar gjatë 20 viteve të fundit. Problematike paraqiten rastet kur debitori kundërshton veprimin përmbartimor të caktimit të çmimit të sendit të sekuestruar. Gjatë këtyre gjykimeve, duket se është akoma e paqartë se vlera e kolateralit e përcaktuar nga përmbartuesi, që e ka këtë detyrë të rregulluar me ligj, nuk është ajo për të cilën kolaterali duhet të shitet, por thjesht një vlerë bazë nën të cilën nuk mund të pranohet asnjë lloj oferte.

Një problematikë tjetër përbën praktika e aplikuar nga Gjykata sipas së cilës kjo e fundit mund të disponojë të drejtën e shtyrjes së afatit të ekzekutimit të detyrimit në të holla, ose kredisë, ose ta ndajë atë në këste. Në këtë kuadër, Gjykata merr një rol aktiv dhe pozicion të njëanshëm në favor të debitorit.

Duhet theksuar se kredia bankare, si marrëdhënie e mirëpërcaktuar nga kuadri rregullativ i miratuar nga Banka e Shqipërisë, duhet të konsiderohet si një marrëdhënie krejt e ndryshme në aspektin juridik nga ajo e zakonshmja ndërmjet dy individëve ose personave të ndryshëm juridikë. Krijimi i një marrëdhënie të tillë është e drejtë ekskluzive e institucioneve financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë, si të vetmet institucione që mund të mbledhin depozita dhe të japin hua.





nga Av. Veronika PRIFTI
Drejtuese e Departamentit të
Çështjeve Ligjore
Banka Kombëtare Tregtare

Bankat tregtare, për shkak të veprimtarisë së tyre kredidhënëse, janë përdoruesit më të mëdhenj të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, duke qenë njëherësh dhe oponentët më realistë në drejtim të problematikave që shfaq sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme në faza të ndryshme të zhvillimit të ekonomisë shqiptare, si dhe të nevojave për ndryshime në kuadrin rregullator në fushën e pasurive të paluajtshme.

Më 21 mars 2012, Kuvendi i Shqipërisë votoi ligjin nr.33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", duke shfuqizuar ligjin nr.7843 të vitit 1994 me amendimet e mëpasme të tij, duke realizuar njëherësh një nga angazhimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim.

Ky ligj i ri përcakton si parim themelor të veprimtarisë së Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ZRPP-në, parimin e sigurisë juridike, çka është një element shumë i rëndësishëm, për të garantuar të drejtën kushtetuese mbi pronën. Në këtë ligj, ka një rregullim më të detajuar e më të zbatueshëm, në raport me ligjin që shfuqizohet, si në drejtim të garantimit të të dhënave të administruara në regjistrat e pasurive të paluajtshme, ashtu dhe në drejtim të sigurisë mbi pronën dhe të

Ligji i ri për regjistrimin e pasurive të paluajtshme dhe ndikimi i pritshëm në praktikën bankare të huadhënies

Ligji i ri sjell përmirësime në anën funksionale të ZRPP-së, garantimin e sigurisë juridike dhe transparencën e veprimtarisë së institucionit më të rëndësishëm, lidhur me pasuritë e paluajtshme.

drejtën e pronarit mbi këtë pronë, ose dhe palëve të treta, që në një nga format ligjore kanë fituar /regjistruar të drejta reale mbi këtë pronë.

Konkretisht, ligjvënësi i ngarkon ZRPP-së, si një detyrim ligjor të shprehur, garantimin e informacionit që administrohet dhe shpërndahet prej saj, lidhur me të drejtën e pronësisë dhe të drejtat reale të regjistruara mbi pasurinë e identifikuar si objekt i kësaj të drejte dhe mbi vetë subjektin mbajtës të kësaj të drejte, duke përcaktuar si rastet e përgjegjësisë së kësaj zyre, ashtu dhe detyrimin për dëmshpërbllim ndaj palës së dëmtuar. Për ta bërë realisht të aplikueshme garancinë civile të ZRPP-së në këto raste, si dhe për të mundësuar shpërbllimin financiar të të dëmtuarit, ligji për herë të parë parashikon krijimin e një fondi rezervë, që do ketë natyrën e një garancie/sigurie për rastet e dëmshpërblimeve. Ky është një moment shumë i vlefshëm për përdoruesit e sistemit të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në përgjithësi dhe në veçanti për bankat tregtare të cilat, për efekt të veprimtarisë së tyre huadhënëse, ndeshen çdo ditë me informacion nga regjistrimi i pasurive të paluajtshme, e në jo pak raste, ky informacion ka qenë i paplotë ose i pasaktë, ose i tillë që ka kompromentuar të drejtën e bankave për të përdorur pronën, ose të drejtat reale mbi këtë pronë, për garantimin, ose vjeljen e detyrimeve të huave.

Për herë të parë ky ligj mundëson konsultimin e regjistrimit elektronik të pasurive të paluajtshme për

subjekte publike, ose private, çka pritet të sjellë avantazhe praktike për bankat në shkurtimin e faktorit kohë dhe mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore gjatë procesit të verifikimeve paraprake për kreditimin. Gjithashtu, konsultimi i këtij regjistri do të ndihmojë në identifikimin e pronave të mundshme të debitorëve, ose dorëzanësve të huave të pashlyera, si edhe për monitorimin e gjendjes së aplikimit të bankës për prona kolaterale, ose në proces ekzekutimi të detyrueshëm, duke synuar dhe shmangien e rasteve të mosveprimeve jo në përputhje me detyrën, ose dhe mosveprimet abuzive, me qëllim vonimin, ose pengimin e realizimit të të drejtave të bankës ndaj një pasurie të paluajtshme.

Nisur nga eksperiencat shpesh jopozitive të këtyre dy dekadave, ligji i ri bën një rregullim më të plotë të mekanizmit për përmirësimin dhe përditësimin e të dhënave të krijuara dhe të administruara aktualisht në ZRPP. Problemi më i rëndësishëm dhe që prek më shumë praktikën bankare të huadhënies dhe të ekzekutimit të kolateraleve nëpërmjet Përmbarrimit, është problemi i kufizimeve të cilat u vendosen pasurive të paluajtshme me urdhër të Regjistruarit, kur nga faktet ose nga dokumentet e paraqitura, ose të administruara në ZRPP, konstatohet se e drejta e pronarit për të vepruar mbi pasurinë e paluajtshme është e kufizuar. Në dallim nga ligji që shfuqizohet, në ligjin e ri vendosja e masës së kufizimit mbi pasurinë e paluajtshme, trajtohet në mënyrë më të arsyeshme, ku tashmë

janë mirëpërcaktuar kushtet e vendosjes së kufizimit dhe procedurat e ankimit për këtë kufizim, si dhe fakti se kohëzgjatja e kufizimit nuk mund të jetë më tej se 30 ditë, e që vetëm gjykata mund ta zgjatë vlefshmërinë e masës së kufizimit tej këtij afati. Kjo do të ndihmojë bankat, veçanërisht në rastet e vendosjes së masave të kufizimit mbi pasuritë e paluajtshme në momentin e aplikimit për kalimin e pronësisë në favor të bankës, duke eliminuar hapësirën ligjore për të ashtuquajturat “kufizime pa limit”, ose pa një arsye të qartë e pa referencë shkaku ligjor.

Gjithashtu, ligji i ri është përpjekur të bëjë një rregullim pak më të mirë, në drejtim të regjistrimit të ndërtimeve të reja në fazën e karabinasë, si regjistrime të përkohshme, për efekt kreditimi dhe regjistrimi të kontratave paraprake. Megjithatë, regjistrimi i kontratave paraprake i lihet kërkesës së palës së interesuar si një mundësi, ndërkohë që për bankat do ishte më e pranueshme që, kontratat paraprake, që lidhen me ndërtimin e ri ose me pjesë të tij, të përcaktohenin nga ligji si detyrueshëm të regjistrueshme, duke eliminuar hapësirat ligjore të përdorimit të pjesëve të ndërtimit të ri për garantim huaje, kur për to kanë nënshkruar edhe kontrata paraprake me palë të treta. Kjo do të mbronte edhe pozitën e palëve të treta, veçanërisht të individëve, të cilët mund të ndodhen në pozita jo të favorshme, ose përfshihen në konflikte gjyqësore për të drejtat e tyre mbi këtë ndërtim të ri, për shkak të mosnjohjes së mundësive që u jep ligji, ose nga praktika e derisotme e përdorimit të kontratave



Për herë të parë ky ligj, mundëson konsultimin e regjistrimit elektronik të pasurive të paluajtshme për subjekte publike ose private, çka pritet të sjellë avantazhe praktike për bankat në shkurtimin e faktorit kohë dhe mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore gjatë procesit të verifikimeve paraprake për huadhënien.

paraprake, të hartuara njëanshmërisht nga subjektet ndërtuese,

Nga pikëpamja administrative, ligji e përcakton për herë të parë ZRPP-në si një institucion jobuxhëtor, që vetëfinancohet nga të ardhurat e krijuara prej veprimtarisë së saj, ku një pjesë e saj do të përdoret për krijimin e rezervës vjetore (fondit), si garanci për dëmshpërblimet ndaj të tretëve. Gjithashtu, për herë të parë në ligj parashikohet që, ZRPP-ja të ketë një bord drejtues, me përfaqësues nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave. Ky organ kolegjal ka det-

yra e kompetenca të qarta, përmes të cilave synohet monitorimi i politikave në fushën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe kryerja e veprimtarisë së ZRPP-së, në funksion të mbrojtjes së të drejtës së pronës.

Hyrja në fuqi e këtij ligji natyrisht do shoqërohet dhe me një proces të gjatë të rishikimit të akteve nënligjore respektive, ose me hartimin e akteve të reja. Bankat, nëpërmjet Shoqatës së tyre, mund dhe duhet të kërkojnë të jenë pjesë aktive e këtij procesi, me synim krijimin e një klime të favorshme në zbatimin e ligjit, e veçanërisht të parimit të sigurisë juridike.

KËSHILLI PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË, NJË STRUKTURË E RE E DETYRUESHME PËR SHOQËRITË TREGTARE

Bazuar në ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010, shoqëritë tregtare në Shqipëri janë të detyruara të ngrenë brenda strukturave të tyre Këshillin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Bankat janë ndër të parat subjekte që e kanë zbatuar këtë kërkesë ligjore.

Një rast konkret është ai i Intesa Sanpaolo Bank Albania, e cila e ka krijuar që në shtator të vitit 2011 Këshillin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Ky Këshill ka si qëllim përmirësimin e sigurisë dhe të shëndetit të punonjësve të bankës, ku ndër funksionet kryesore është vlerësimi i rreziqeve dhe parandalimi e eliminimi i tyre në punë, si dhe siguri i shëndetit fizik dhe mendor të punëmarrësve. Ai përbëhet nga 12 persona nga të cilët 6 janë përfaqësues të punëdhënësit dhe 6 janë përfaqësues të punëmarrësve. Në një broshurë të botuar enkas për Zgjedhjet e këtij Këshilli u pasqyrua lista e kandidatëve që shprehën interes të jenë përfaqësues të punëmarrësve, një prezantim i shkurtër i tyre dhe një mesazh për kolegët. Në zgjedhjet e para të zhvilluara në Shtator u ftuan të merrnin pjesë në votim të gjithë punonjësit e bankës. Gjithsej votuan 409 nga 538 persona, pra 76% e punonjësve.

Këshilli në dy mbledhjet e para ka diskutuar ndër të tjera mbi përzgjedhjen e shoqërisë që do të ndjekë çështjet e shëndetit të punonjësve të bankës, pajisjen e të gjitha degëve me kutitë e ndihmës së shpejtë, reduktimin ose eliminimin e zhurmave të shkaktuara nga printerat apo pajisjet e tjera në Zyrat Qendrore.



KARTA PREPAID

0%

komision

Me kartën Prepaid
nuk paguhen
komisione mujore!



☎ 04 22 34 096 @ www.bankcredins.com

KARTAT ERDHËN!

Për herë të parë në Shqipëri Kartat e Parapaguara Visa!

Karta Prepaid është një kartë e parapaguar. Kjo kartë përdoret për blerje brenda dhe jashtë vendit, në pikat e shitjes me kartë, në internet dhe në ATM. Nëse ju mbarojnë lekët, ejani tek ne për ta rimbushur përsëri. Me Kartë Prepaid ju pajiseni në çast.

Pajiseni në çast!

 **CREDINS bank**



KONKURRENCA NË TREGUN E BONOVE TË THESARIT

Pavarësisht nga diskutimet dhe debatet e herëpashershme, tregu parësor dhe dytësor i bonove të thesarit është i hapur për të gjithë dhe funksionon sipas mekanizmit të kërkesë-ofertës.

nga Klodian TOMORRI

Në fund të vitit 2007, borxhi i brendshëm i qeverisë që mbahej nga individët ishte vetëm 7 për qind e totalit. Sipas të dhënave zyrtare nga Ministria e Financave në fund të vitit të kaluar pesha e individëve në borxhin e brendshëm të qeverisë arriti në 13 për qind. Madje të dhënat më të fundit të Bankës Qëndrore tregojnë se në fund të marsit shifra shkoi për herë të parë në 60 miliardë lekë ose rreth 14 për qind ne totalit. Struktura e mbajtësve të borxhit të qeverisë është e diversifikuar, pavarësisht se ky borxh dominohet nga zotërimet e sistemit bankar. Në fund të vitit të kaluar, dy mbajtësit më të mëdhenj të borxhit të brendshëm shtetëror ishin: Banka e Shqipërisë, me 14.3 për qind të totalit dhe një bankë private me 33.7 për qind të tij. Bankat e tjera private zotërojnë të marra së bashku 35.5 për

Nëse yield-et e bonove të thesarit mbeten të qëndrueshme dhe nuk bien, kjo nuk varet nga numri i investuesve në treg më shumë sesa nga një kompleks faktorësh, të lidhur me thellësinë e tregut financiar, strukturën e tij, konkurrencën ndërsektoriale, gamën e instrumenteve, rreziqeve që shoqërojnë instrumentet dhe produktet financiare, etj.



qind të tregut, ndërsa pjesa tjetër nga individët dhe bizneset. Ndonëse me një strukturë të diversifikuar, tregu i bonove të thesarit, veçanërisht tregu parësor, shpesh ka qenë objekt debati në lidhje me konkurrencën. Sa herë që normat e interesit të letrave me vlerë rriten, debati rindizet dhe ka një ndjeshmëri të pazakontë. Në rastin e individëve, shpesh është etiketuar si barrierë, shuma kufi, e nevojshme për të marrë pjesë në një ankand, rreth 300 mijë lekë, të cilat duhet të kalohen në Bankën e Shqipërisë përmes një llogarie në një bankë tregtare. Megjithatë, tani tregu ofron mundësi edhe për ata që duan të investojnë shuma më të vogla, madje shumë herë më të vogla. Në Shqipëri pak javë më parë u krijua zyrtarisht fondi i parë i menaxhimit të aktiveve, brenda të cilit përfshihet

dhe një fond investimesh, me fokus letrat me vlerë të qeverisë. Përmes tij, individët mund të investojnë në bono thesari edhe me vetëm 5 mijë lekë.

Konkurrenca

Bonot e thesarit emetohen në tregun parësor nga qeveria nëpërmjet ankandit. Kjo formë nënkupton që investuesit duhet të konkurrojnë për blerjen e këtij instrumenti. Tregtimi në tregun dytësor mund të bëhet me subjektet e licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ku bëjnë pjesë edhe bankat tregtare. Vitin e kaluar AMF licencoi edhe dy subjekte të tjera që mund të tregtojnë letrat me vlerë në tregun sekondar. Shpesh tregu i letrave me vlerë ka qenë në qëndër të debatit nëse është një treg konkurrues apo i përqëndruar. Në të kaluarën madje ka patur dhe

Ligjërisht, tregu i bonove të thesarit, si ai parësor dhe ai dytësor, është i hapur për këdo. Ligji nuk ka asnjë barrierë që ndalon ata që duan të investojnë në letra me vlerë të qeverisë, qofshin këto biznese, institucione financiare apo dhe individë, në dallim nga jo pak praktika ndërkombëtare, që e kufizojnë pjesëmarrjen e individëve në tregun parësor.

përplasje institucionale mes Bankës së Shqipërisë dhe Autoritetit të Konkurrencës. Të dy palët kishin argumentet e tyre. Autoriteti kërkonte që Banka e Shqipërisë të rikthente sportelet e bonove për individët që këta të fundit të investonin drejtpërdrejt në bonot e thesarit, pa u detyruar që më parë të hapnin llogari në një bankë të nivelit të dytë. Por rikthimi i sporteleve nënkuptonte se individët duhet të lëviznin shuma të mëdha në cash. Në të kaluarën Banka Qëndrore është akuzuar

se përmes kësaj procedure kishte krijuar hapsira për pastrim parash. Ndoshta ky ishte dhe argumenti se pse Banka e Shqipërisë vendosi që pjesëmarrja në ankandet e bonove të bëhej përmes bankave private. Tregu parësor i bonove të thesarit ka qenë gjithmonë i hapur dhe pa asnjë kufizim ligjor për pjesëmarrjen, e për sa kohë një treg nuk ka barrierë ligjore për hyrjen, struktura e tij përcaktohet mirëfilltazi nga interesi ekonomik. Të gjithë ata individë apo biznese që e shikojnë të leverdishëm

ekonomikisht të investojnë në bono thesari mund ta bëjnë këtë në çdo moment. Ata që nuk kanë investuar deri tani, nuk janë penguar nga ligji, por thjesht sepse nuk e kanë parë si një alternative të leverdisshme investimi, nuk kanë fonde për të investuar, apo për shumë arsye, nuk arrijnë të investojnë.

Nga ana tjetër, në një sistem financiar ku mbi 95 për qind e aktiveve financiare zotërohen nga bankat tregtare, të cilat realizojnë dhe pjesën dërrmuese të ndërmjetësimit financiar, përcaktuesit kryesorë të çmimit të tyre do të jenë patjetër bankat. Në një ekonomi tregu, krijuesit e tregut përcaktojnë çmimet, sipas ligjit të kërkesë - ofertës e nëse kërkesa për likuiditete është vazhdimisht e lartë, po i lartë do të vijojë të jetë dhe çmimi që do të duhet të paguhet për ta patur këtë likuiditet.

INFORMACION I HAPUR



Kalendari i ankandëve të emetimit të bonove të thesarit përcaktohet nga qeveria. Ankandet për emetimin e bonove të thesarit me afat maturimi 3 dhe 6-mujor, organizohen një herë në muaj, ndërsa ankandet për emetimin e bonove me afat maturimi 12-mujor organizohen çdo dy javë. Ankandet normalisht zhvillohen ditën e martë, ndërsa emetimi i letrës me vlerë bëhet dy ditë më vonë, ditën e enjte. Zhvillimi i ankandit njoftohet paraprakisht nga Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë nëpërmjet publikimit të informacionit në faqet respektive të internetit. Individët mund të marrin pjesë në ankandet e emetimit të bonove të

thesarit me kërkesa konkurruese ose jokonkurruese. Pjesëmarrja me kërkesë konkurruese nënkupton vendosjen e një interesi (yield-i) mbi bazën e të cilit do të llogaritet çmimi që investuesi preferon të paguajë për blerjen e bonos së thesarit. Pjesëmarrja me kërkesë jokonkurruese nënkupton pranimin e yield-it mesatar të ponderuar, i cili do të llogaritet si mesatare e ponderuar e yield-eve të kërkesave konkurruese të shpallura fituese. Në ankand, kërkesat konkurruese renditen nga yield-i më i ulët i kërkuar deri tek yield-i më i lartë deri sa shuma e shpallur nga qeveria për emetimin e bonove të thesarit, të plotësohet.



Ledia PLAKU (LL.M)
Drejtoreshë, Departamenti Ligjor
Intesa Sanpaolo Bank
Albania

TRANSPARENCA NË KONTRATAT BANKARE – NJË KËNDVËSHTRIM LIGJOR

Marrëdhëniet bankë-klient kanë pësuar një ridimensionim cilësor, pas ndryshimeve të bëra pak viteve më parë nga Banka e Shqipërisë, duke u mundësuar klientëve një informacion thelbësor, për t'iu mundësuar atyre një vendimmarrje sa më të mirëinformuar dhe të përshtatshme.

Transparenca është një nocion i gjerë e që përgjithësisht përkufizohet si komunikim, si të qenurit i hapur e i përgjegjshëm. Në këtë kuadër, transparenca e kushteve kontraktore të produkteve dhe shërbimeve bankare ka një vëmendje të veçantë në aktivitetin e përditshëm të bankave. Informacioni i qartë dhe i saktë mbi produktet dhe shërbimet bankare, i trupëzuar në kontratat bankare është detyrim për t'iu përmbushur nga ana e bankave, të cilat në këtë mënyrë minimizojnë shkallën e konflikteve me klientët si dhe humbjen e reputacionit në treg. Nga këndvështrimi i klientit, transparenca mundëson zgjedhjen e lirë, krahasimin e ofertave të ndryshme në treg që pasohet me përzgjedhjen e kujdesshme dhe brenda nevojave e potencialeve të tyre paguese të një ose disa produkteve. Ndërsa në nivel të përgjithshëm, transparenca siguron jo vetëm një konkurrencë të ndershme mes vetë bankave, mundësi për të vërtetuar se kushtet e publikuara në reklama janë ekzaktësisht ato që ofrohen, por gjithashtu çon dhe në uljen e kostove të produkteve bankare.

Bankat janë të detyruara sipas Ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" (neni 124), që për çdo shërbim ose produkt bankar të ofruar të nën-

shkruajnë një marrëveshje (kontratë) me shkrim me klientin. Nisur nga natyra komplekse e këtyre kontratave, ligji kërkon që, dhënia e informacionit parakontraktor të jetë sa më i plotë dhe i gjithanshëm, me qëllimin që klienti të kuptojë e të përvetësojë çdo detaj të transaksionit bankar të synuar. Si rezultat i ndërhyrjeve të Bankës së Shqipërisë në formulimin e dispozitave kontraktore, është shfaqur fenomeni i "uniformizimit të

Për sa kohë veprimtaria bankare është e një interesi publik, është detyrë e ligjvënësive të baraspeshojë parimet konkurruese, të tilla si: "vullneti i lirë kontraktor" dhe "mbrojtja e konsumatorit", e më tej të vendosë një raport të drejtë e të arsyeshëm midis tyre.

kontratave bankare". Kështu, kontratat bankare nga kontrata tip, formulimi i të cilave kryhej paraprakisht në mënyrë të njëanshme nga ana e vetë bankave dhe ku klienti ishte në situatën e pranimit ose të refuzimit të tyre në formatin e ofruar, janë duke u transformuar në kontrata, formulimi i të cilave është i normuar dhe i rregulluar paraprakisht sipas Rregulloreve të Bankës së Shqipërisë. Këtu lind pyetja: Sa të lira janë bankat në ndërtimin e marrëdhënies kontraktuale me klientin? Në pamje të parë, duket sikur kemi të bëjmë me cenim të parimit të vullnetit të lirë kontraktor, por nga një interpretim tërësor arrijmë në përfundimin se për sa kohë veprimtaria bankare është e një interesi publik e si e tillë ajo është e "detyruar" të ushtrohet brenda një kuadri ligjor të mirëpërcaktuar, është detyrë e ligjvënësive (në këtë kontekst Banka e Shqipërisë) të baraspeshojë parimet e ndryshme të së drejtës që konkurrojnë, të tilla si "vullneti i lirë kontraktor" përkundrajt "mbrojtjes së konsumatorit", e më tej të vendosë një raport të drejtë dhe të arsyeshëm midis tyre.

Ndër elementet e veçanta, të përfshira në kontratat bankare, si rrjedhojë e ndryshimeve më të fundit të akteve rregullative të Bankës së Shqipërisë evidentohen:

OFERTAT MË TË MIRA DHE KONKURUESE
NË TREGUN BANKAR!




CBA JU OFRON:

Depozita, llogari rrjedhëse dhe me afat, tranferta parash, garanci bankare,
shkembime dhe te gjitha sherbimet tradicionale bankare

Adresa: Rr. "Perlat Rexhepi",
Ndërtesa Administrative "AL-KHARAFI" (prane Fakultetit
Juridik), Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2 272168/66; Fax: + 355 4 2 272162
E-mail: creditbkalb@icc-al.org
creditcba@icc-al.org

SheratonTirana Hotel
Shopping Plaza
Tel: +355 4 2 2255372/388/368/346
Fax: +355 4 2 255340

Hotel "Butrinti", Sarandë
Tel: +355 85 2254 05



Informacioni i qartë dhe i saktë mbi produktet dhe shërbimet bankare, i trupëzuar në kontratat bankare është detyrim për t'u përmbushur nga ana e bankave, të cilat në këtë mënyrë minimizojnë shkallën e konflikteve me klientët si dhe humbjen e reputacionit në treg.

E drejta e tërheqjes së klientit nga kontrata/marrëveshja e huasë konsumatore

Sipas nenit 11 të Rregullores së Bankës së Shqipërisë nr. 05, datë 11.02.2009 "Për huanë konsumatore dhe huanë hipotekare për individët", klienti ka të drejtën të tërhiqet nga kontrata e huasë konsumatore pa dhënë ndonjë arsye për këtë qëllim, brenda një periudhe kalendarike 14 ditore, ku ky afat fillon nga dita e lidhjes së kontratës, ose e marrjes dizeni për kushtet kontraktore. Në një rast të tillë, nëse është lëvruar pjesërisht ose tërësisht shuma e kryegjësë, klienti detyrohet të kthejë shumën e kryegjësë së lëvruar dhe interesin për ditët përkatëse, si dhe shpenzimet e mundshme të bankës, të krijuara nga veprime me palë të treta për efekt të lëvrimit të huasë, të cilat duhet të jenë të përfshira në çdo rast në informacionin kontraktor.

E drejta e shlyerjes së huasë para maturimit të afatit kontraktor

Një tjetër risi e ndryshimeve më të fundit të Bankës së Shqipërisë, është

sanksionimi i së drejtës së shlyerjes së huasë para maturimit të afatit kontraktor. Sipas nenit 12 të Rregullores së Bankës së Shqipërisë nr. 05, datë 11.02.2009 "Për huanë konsumatore dhe huanë hipotekare për individët", parashikohet që konsumatori ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, edhe para afatit të maturimit, shlyerje të pjesshme ose të plotë të detyrimeve të tij të lindura nga kontrata e huasë konsumatore. Në këtë pikë, legjislacionet e vendeve të ndryshme parashikojnë se edhe nëse i njihet një e "drejtë" e tillë huamarrësit, ajo mund të ushtrohet vetëm në afate periodike të përcaktuara paraprakisht në kontratën e huasë (për shembull çdo 5-vjet). Kjo bëhet jo vetëm me qëllim mbrojtjen e interesave të depozituesve individualë, por dhe të bankave, të cilat mund të kenë bërë investime afatgjata në instrumente të ndryshme të tregut. Përveç së drejtës së shlyerjes para afatit të maturimit, në rregulloren e sipërpërmendur përcaktohen dhe kufijtë maksimalë të kompensimit, që mund të kërkojë banka për shlyerje para afatit (jo më

shumë se 2 për qind e shumës së huasë të paguar, nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të huasë është mbi 1 vit dhe jo më shumë se 1 për qind, nëse kjo periudhe nuk kalon 1 vit).

Kushtet e kontratave të huasë

Nëpërmjet Rregullores së Bankës së Shqipërisë nr. 59, datë 29.08.2008 "Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare", sanksionohen kushtet e detyrueshme, që duhet të përmbajnë klauzolat e kontratave bankare, të cilat dukshëm përmirësuan praktikën e mëparshme bankare ku këto klauzola ishin opake dhe jo lehtësisht të përcaktueshme.

Në këtë kuadër, ndër elementet që shënojnë risi përmenden:

- Norma e interesit, ku qëllimi është krijimi i një pasqyre të qartë e të kuptueshme, mbi mënyrën e ndryshimit të interesit kontraktor, përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, për klientin qysh në fazën para-kontraktore.
- Norma efektive e interesit dhe totali i kostos së huasë, ku me "ko-

sto totale të huasë” nënkuptohet tërësia e të gjitha shpenzimeve, përfshirë këtu dhe interesat, komisionet, ose çdo lloj tjetër shpenzimi, që klienti paguan në lidhje me marrëveshjen e huasë sipas kushteve të saj, kurse me “Normën Efektive të Interesit, (NEI)” nënkuptohet totali i kostos së huasë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së huasë së dhënë dhe e llogaritur në përputhje me metodën e përlllogaritjes së përcaktuar në Rregulloren e Bankës së Shqipërisë nr. 59, datë 29.08.2008 “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”.

- Përshkrimi i detajuar i rreziqeve që lidhen me huanë, ku i tërhiqet vëmendja klientit për rreziqet me të cilat mund të përballlet, në rast të huamarrjes në valutë, ose në rastet kur të ardhurat e klientit janë në monedhë të ndryshme nga ajo e të ardhurave të tij, si pasojë e lëvizjeve të pafavorshme të kursit të këmbimit, ose rreziqet e lidhura me normat e ndryshueshme të interesit, përgjatë kohëzgjatjes së huasë.
- Ndryshimi i kushteve kontraktore, nëpërmjet të cilave është synuar t'i jepet fund praktikave të tilla ku bankat parashikonin ndryshimin e kushteve kontraktore, kryesisht sipas gjykimit të tyre. Në vijim të parimit: “Kontrata ka forcën e ligjit ndërmjet palëve dhe mund të ndryshohet vetëm me pëlqimin e vetë palëve”, është parashikuar, që bankat duhet të njoftojnë paraprakisht me shkrim klientin, përpara se ndryshimet e kontratave bankare të hyjnë në fuqi (sipas nenit 5 pikat 4 dhe 5, të Rregullores së Bankës së Shqipërisë nr. 59, datë 29.08.2008). Gjithsesi, aplikimi i saktë i këtij rregulli kërkon që banka të ketë në çdo rast një bazë të aktualizuar të dhënash të klientëve dhe një sistem adresash të unifikuar, gjë jo e lehtë në praktikë.

Në përfundim, frytet dhe dobia praktike e transparencës për publikun kërkojnë, krahas të tjerave, edhe kultivimin e një kulture besimi dhe bashkëpunimi më të ngushtë e të vazhdueshëm Bankë – Klient.

ALO 116

Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë



ALO 116 është një shërbim i dedikuar për fëmijët i cili ofron këshillim psikologjik, informim dhe referim në shërbimet përkatëse sipas specifikës së rastit. Ky shërbim është në dispozicion të të gjithë fëmijëve në mbarë vendin, 24 orë në 7 ditë të javës, gjatë gjithë vitit.

Në 3 vjet shërbime, ALO 116 u është përgjigjur mbi 300,000 telefonatave të fëmijëve, prindërve dhe mësuesve. Në vitin 2011 këshilluesit e linjës u janë përgjigjur më shumë se 138,000 telefonatave.

ALO 116 është një nga linjat e këshillimit më të reja në Europë. Vazhdimësia e ALO 116 dhe shërbimet që ofron Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijët varen nga bashkëpunimi dhe kontributi i anëtarëve të ndryshëm të shoqërisë.

ALO 116 është një nga kauzat më të mëdha për të drejtat e fëmijëve me të cilin çdokush (individ apo institucion) në Shqipëri mund të bashkangjisë emrin e tij duke u bërë:

1. Pjesë e aktiviteteve për mbledhjen e fondeve të ALO 116
2. Sponsor i ALO 116
3. Mik i ALO 116

Për më tepër kontaktoni në:
Tel: + 355 4 2242264
e-mail:eni.bogdani@alo116.al

www.alo116.al

GRABITJA E BANKAVE DHE RUAJTJA E VENDIT TË NGJARJES



nga Roland TASHI
Nënkryetar i Komitetit të AAB-së
për Sigurinë Bankare

“Grabitësi i të premtës”, ai që tronditi opinion publik me veprimet e tij, e ndërpreu ritualin kriminal pas përfundimit në pranga si pasojë e një ngjarje tepër të rëndë në datën 27 mars 2012. Ngjarja e fundit ishte grabitja e një njësie biznesi të Bankës Kombëtare të Greqisë, në një zonë të Tiranës, ku si pasojë e përdorimit të armës, humbi jetën një punonjëse e bankës dhe u plagos punonjësi i sigurisë. Kush e ndërpreu zinxhirin e krimit, i cili vazhdonte të ishte prezent duke mbajtur nën presion punonjësit e bankave, strukturat e sigurisë së tyre si dhe organet e policisë në Tiranë dhe në rrethe?

Përveç punës operative të strukturave përkatëse të Policisë së Shtetit, rol shumë të rëndësishëm dhe përcaktues luajtën telekamerat e instaluar në bankë si dhe ato të instaluar nga një biznes tjetër pranë saj. Pikërisht në zonën që ky biznes mbulonte me vëzhgimin e telekamerës së jashtme, kaloi grabitësi pas largimit nga vendngjarja. “Pakujdesia e treguar” prej kriminelit, nga mosnjohja e zonës, solli si pasojë heqjen e veshjeve të përdorura për maskim dhe “ekspozimin” shumë të qartë të tij në këtë telekamera gjatë largimit pas krimit të kryer.


Si funksionon sistemi i mbrojtjes

me telekamera, apo siç e njohin specialistet e sigurisë: sistemi televiziv me qark të mbyllur (CCTV) dhe përse është i nevojshëm ky sistem mbrojtje?

Vëzhgimi i një zone të caktuar, që vlerësohet se ka një shkallë rreziku të caktuar, realizohet nëpërmjet instalimit të telekamerave si dhe regjistrimit të pamjeve të shfaqura para tyre. Shfrytëzimi i këtij informacioni të grumbulluar në pajisjet regjistruese ndihmon strukturat e sigurisë në banka, dhe agjencitë e zbatimit të ligjit, për të verifikuar dhe për të kontrolluar lëvizjet dhe qarkullimin në një zonë të caktuar.

Informacioni i regjistruar nga

Skena e krimit, është pa dyshim një nga elementet më të rëndësishme për të zbuluar kush është autori i një ngjarje kriminale. Analiza e detajuar dhe shkencore e skenës së krimit është një nga operacionet më delikate e më të rëndësishme gjatë një hetimi.





Emporiki Bank

CRÉDIT AGRICOLE GROUP

Anëtare e Grupit më të Madh Bankar në Francë



këto sisteme merr rëndësi të veçantë kur brenda zonës së vëzhgimit të telekamerave ka ndodhur një vepër kriminale, grabitje me armë, vrasje etj. Në këtë rast, zona e vëzhguar do të konsiderohet si vendngjarje, ose skenë e një krimi. Specialistët e sigurisë së bankave, si dhe të objekteve të tjera, ku ka të instaluar sisteme televizive me qark të mbyllur, në rastet e veprimeve kriminale brenda objekteve të tyre nuk duhet të mjaftohen vetëm me ruajtjen e informacionit të regjistruar në pajisjet regjistruese, që pa dyshim është i rëndësishëm gjatë procesit të “zbardhjes” së krimit, por edhe në mbrojtjen e paprekur të vendit të ngjarjes, deri në mbërritjen e organeve të specializuara të shtetit.

Praktikat e policive shkencore Evropiane tregojnë se vendi ku ka ndodhur një ngjarje kriminale është vendi ku do të vazhdojnë të punojnë ekspertët e kriminalistikës dhe ata të kriminologjisë. Në skenën e krimit ndodhet pika e takimit midis një shkence më teorike që është kriminologjia, dhe asaj më praktike që është kriminalistika. Skena e krimit, në vijim të përcaktimeve të mundshme, është një urë komunikimi e krijuar nga autorët e krimit, një “urë”, e cila në rast se nuk është e mbuluar me vëzhgim me sistemet televizive me qark të mbyllur, mbetet e vetmja mundësi për të zbuluar kush e ka kryer krimin, cilët janë bashkëpunëtorët, etj. Gjatë një hetimi ka raste që nuk ka dëshmitarë, ose ata nuk janë të gatshëm të bashkëpunojnë, ndërsa vendi i ngjarjes është gjithmonë prezent. Ai mund të jetë i vogël, nuk mund të ofrojë shumë

...“kur dy objekte hyjnë në kontakt me njëri-tjetrin, çdo njeri lë diçka nga vetja tek tjetri, pra një individ që kryen një krim lëshon diçka nga vetja në skenën e krimit dhe paralelisht ai merr me vete diçka nga ky vend”.

të dhëna, ose i vështirë për t’u analizuar, por sidoqoftë ai ekziston dhe mund të analizohet e të studiohet në çdo kohë.

Për specialistët e sigurisë në banka, ose në objekte të tjera, ku ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre, është e rëndësishme të kuptohet çfarë është fizikisht një skenë krimi. Brenda një vendi ngjarje, ose skene krimi, gjenden tri zona të ndryshme, të gjitha shumë të rëndësishme për kryerjen e hetimit: (1) zona e parë, ku është kryer akti kriminal, ose ku është zbuluar viktimia, (2) zona e dytë (gjithmonë pranë zonës së parë), ku ekziston probabiliteti më i madh që autori i krimit të ketë kryer veprime për arritjen e qëllimit, ose ku ka filluar agresionin ndaj viktimës, (3) zona e tretë, ose drejtimi nga ku autori është larguar pas kryerjes së krimit. Analizimi i zonës së tretë, solli pikërisht kapjen e autorit të ngjarjes së datës 27 mars 2012 të Banka Kombëtare e Greqisë në Tiranë.

Specialistët e sigurisë në banka, ose në objekte të tjera të rëndësishme ekonomike e shoqërore, nuk duhet të ndërhyjnë në vendngjarje, sidomos kur këtu është kryer një vepër kriminale, shoqëruar me dhunë, grabitje, ose vrasje. Për këtë çështje ata duhet të informojnë dhe të trajnojnë në vazhdimësi punonjësit, dhe në veçanti ata që punojnë në zonën e sporteve. Skena e krimit duhet të mbrohet në mënyrën më të mirë të mundshme. Megjithatë, në vendngjarje në disa raste është e domosdoshme të ndërhyhet, sidomos nga ekipet mjekësore të ndihmës së shpejtë për të mbikëqyrur, ose për

të shpëtuar të lënduarit. Gjithsesi, është e rëndësishme, që pas largimit të tyre, vendngjarja të ruhet deri në mbërritjen e eksperteve të Policisë Shkencore. Përcaktimi i skenës së krimit në hapësirë dhe në kohë, mundëson fillimin e punës për analizën e gjurmëve dhe elementeve të tjerë brenda saj. Për analizën e skenës së krimit ka disa metoda: (1) kërkimi sistematik i quajtur në formë “grile”, ose ndryshe verifikimi i elementeve duke e ndarë zonën në rreshta paralele dhe duke kërkuar në mënyrë kronologjike brenda këtyre zonave gjatësore, dhe (2) kërkimi “pikë për pikë”, ku procedohet duke filluar nga pikat më të dukshme e më të rëndësishme, së pari nga viktimia, e më pas tek objektet me më shumë interes.

Kur skena e krimit nuk është në mjedise të brendshme, por jashtë, në mjedise të hapura, ajo ndahet në sektorë drejtkëndorë, për të lejuar kërkimin sa më të detajuar të zonës, duke përjashtuar mundësinë e kërkimit disa herë brenda një zone. Në rast se në skenën e krimit janë përdorur armë zjarri, thika ose mjete të tjera të forta dhe dyshohet se ato janë fshehur apo janë hedhur brenda saj, sektorët drejtkëndorë ndahen në rreshta me gjatësi jo më shumë se një metër dhe këtu vazhdon kërkimi me pajisje të veçanta metalkërkuese.

Ekspertët kriminalë të Policisë Shkencore, pas mbërritjes në vendngjarje kanë detyrë kryesore të kërkojnë dhe të depozitojnë gjurmët e mbetura. Në këtë proces një ndihmesë shumë të madhe duhet të japin specialistët e sigurisë, ose punonjësit e shërbimit të brendshëm në banka, të cilët mund të jenë punonjës të këtyre institucioneve, ose të kontraktuar nga Shoqëritë e Ruajtjes dhe Sigurimit Fizik (SHRSF-të).

Kur flasim për gjurmët e lëna në vendngjarje, duhet të përmendim kriminologun e famshëm francez, Edmond Locard, i cili që në vitin 1910 në Lion konceptoi parimin e “këmbimit të ndërjellët”, që shkurtimisht pranon se “kur dy objekte hyjnë në kontakt me njëri tjetrin, çdo njeri lë diçka nga vetja tek tjetri, pra një individ që kryen një krim lëshon diçka nga vetja në skenën e krimit dhe paralelisht ai merr me vete diçka nga ky vend”. Mbështetur në këtë parim, pasi fiksohen dhe fotografohen gjurmët e dukshme, në skenën e krimit vazhdohet me shumë kujdes kërkimi i mbetjeve biologjike si dhe i gjurmëve të tjera.

REFORMIMI I BANKAVE PËRGJIGJE E DUHUR NDAJ KRIZËS



nga Prof. Dr. Adrian CIVICI
Drejtor i Shkollës Doktorale
Universiteti Europian i Tiranës

Procesi i pandalshëm dhe i pashmangshëm i reformimit të sistemit bankar në botë, gjithsesi mbetet një proces kompleks, i shtrirë në kohë dhe nuk mund të ndjekë një recetë standarde për të gjitha vendet.

Kriza financiare globale evidentoi si një nevojë të domosdoshme reformimin e bankave dhe të gjithë sistemit bankar aktual. Në këtë drejtim fillimi i një reforme fundamentale u lajmërua gjatë takimit të G20-ës në prill të 2009-ës, në Londër. SHBA-ja dhe Britania e Madhe, kampionët e derregullimit dhe liberalizimit financiar, në mënyrë paradoksale u ngrorë në favor të “rregullimit bankar” dhe ndarjes së “qartë ndërmjet aktivitetit të depozitave dhe huasë, nga aktivitetet e investimeve në tregje të ndryshme”. Objektivi kryesor ishte: të mbrohen depozitat nga rreziqet spekulative.

Nuk është hera e parë që SHBA-ja synon të frenojnë oksesin e bankierëve të saj. Përkundrazi, ky mund të quhet refren normal, pas shpërthimit të çdo krize të madhe financiare. Të nesërmen e shpërthimit të krizës së depresionit të madh në vitin 1929, Presidenti Frenklin Ruzevelt, në kuadrin e “New Deal” urdhëroi një ndarje të qartë ndërmjet bankave tregtare dhe bankave të investimeve. Ligji i famshëm “Glass-Steagall”, që shpalli papajtueshmërinë ndërmjet bankave tregtare dhe atyre të investimeve, që krijoi dhe sistemin federal të sigurimeve për depozitat bankare, por dhe përcaktoi një tavan për përqindjet e interesit për depozitat, jetoi thuasjse për 70 vjet në SHBA, ndërsa

në Europë ishte Franca që adoptoi një ligj të ngjashëm në mbarim të Luftës së Dytë Botërore.

Por në mbarim të viteve 80-të, konceptet dhe praktikat derregulluese e liberalizuese u rikthyen me forcë. Në 1984-ën, ishte Franca që i dha fund kësaj ndarjeje të bankave, duke iu rikthyer modelit universal dhe në vitin 1986 Kryeministria Britanike, Margaret Theçer, inicioi një proces intensiv e spektakolar derregullimësh në gjirin e City-t të Londrës. Në SHBA filloi gjithashtu një sulm i hapur ndaj ligjit “Glass-Steagall”, sepse si pasojë e konkurrencës europiane dhe britanike, kapitalet amerikane filluan të largohen masivisht drejt Londrës dhe Europës. Kongresi Amerikan nuk rezistoi dot. Në nëntor të vitit 1999, Kongresi duke votuar “Gramm-Leach-Bliley Act” e abrogoi këtë ligj, duke iu rikthyer eksperiencës së bankave universale.

Megjithatë, 9 vite më vonë, Lehman Brothers, simboli financiar “made in USA” falimentoi, duke shkaktuar një panik të jashtëzakonshëm në të gjitha bursat botërore dhe duke detyruar mjaft qeveri që t’i rri-financonin bankat e tyre. Në SHBA, me mijëra njerëz u dyndën në sportelet e bankave të tyre për të tërhequr depozitat duke rikthyer frikën e një “bank run” të ri. Administrata e Presidentit Obama reagoi men-

jëherë duke garantuar depozituesit dhe ndëshkuar bankat. Në korrik të 2010-ës, Presidenti Obama nënshkroi “Dodd-Frank Wall Street Reform and Consumer Protection Act”, i cili i detyronte bankat, duke nisur nga viti 2014, që të “zgjidhnin ndërmjet spekulimit në treg me fondet e tyre (prop trading) dhe aktivitetit si banka të zakonshme tregtare depozitash e huash.

E njëjta situatë ishte dhe në Angli. Vetëm tre vjet mbas injektimit të 70 miliardë eurove, për të evituar falimentimin e Royal Bank of Scotland dhe Lloyds Banking Group, qeveria e Londrës njoftoi për “një reformë radikale” në sistemin e saj bankar, më ambiciozen pas periudhës Theçer. Thelbi i kësaj reforme ishte përsëri “garantimi i depozitave në sistemin bankar britanik”. Në 12 shtator 2011, Komisioni për bankat në parlamentin britanik, i kryesuar nga Xhon Vickers, paraqiti propozimet e reja për reformimin e bankave, të cilat gëzuan mbështetje të plotë nga qeveria konservatore e Devid Kameron-it. Ligji i ri parashikonte një ndarje pjesore, nëpërmjet një sistemi filialesh, ndërmjet aktiviteteve tregtare me depozitat dhe huatë dhe aktiviteteve të investimeve. Depozitat do të ishin të mbrojtura nga rreziqet spekulative dhe nuk do të shërbenin më për të financuar “kazinonë” e tregjeve.

Debatet dhe filozofia e reformimit të bankave duket se më në fund po kanalizohen në dy tema thelbësore që janë: (1) arkitektura e strukturave të sistemit bankar dhe (2) rregullat e reja të administrimit të politikës prudenciale.

Si për të vërtetuar drejtësinë e këtij ligji, vetëm 3 ditë pas miratimit të tij, një spekulator financiar, i quajtur Kweku Adoboli, i humbi bankës më të madhe zvicerane UBS 2.3 miliardë \$, si pasojë e spekulimeve aventurore të tij në treg. Qeveria britanike e mbrojti me krenari ligjin e saj duke u shprehur se: “ky rast dëshmon edhe më shumë se është absurde t’ia lësh depozitat në dorë institucioneve të papërgjegjshme, që mund të bëjnë të shpërthejnë armë financiare të shkatërrimit në masë”. Dhe çfarë ishte më e rëndësishme nga pikëpamja e financave publike, në rast falimentimi të bankave, autoritetet qeveritare ndërhyjnë vetëm për shpëtimin e bankave tregtare dhe jo për të gjithë bankat. Si pasojë e ndërhyrjes së lobit bankar britanik, kjo reformë që kushton 5-8 miliardë euro në vit vetëm për katër bankat më të mëdha britanike, u parashikua që të hyjë në fuqi në vitin 2019. Ky duket si një revolucion i vërtetë në sektorin bankar britanik. Ndërkohë që Londra, në emër të mbrojtjes së interesave të City-t, vuri veton e saj kundër traktatit evropian të disiplinës financiare. Qeveria britanike premton se do të shkojë shumë më larg se Europa në mbrojtje të depozitave bankare.

Ndërkohë, Europa kontinentale duket se nuk është gati të heqë dorë lehtësisht nga sistemi dominues i bankave universal, që strehon nën të njëjtën çati si depozituesit e vegjël dhe depozitat e tyre, ashtu dhe fonde të ndryshme investimesh e spekulative me fitim, por dhe me rrezik të lartë. As kriza e huave hipotekare dhe as ajo e borxheve sovraane nuk e kanë vënë ende në dyshim këtë formulë për

europianët, përkundrazi, në Francë, në Gjermani, në Holandë, në Itali, etj, kjo formë universale e bankave citohehet si “mbrojtëse kundër spekulimeve të tregut”. Argumentet kryesore të evropianëve mbështeten në fakte që i referohen dy falimentimeve spektakolare: “Northern Rock”, që ishte një bankë e zakonshme dhe e thjeshtë tregtare, ndërkohë që gjiganti tjetër “Lehman Brothers” nuk kishte asnjë dollar depozita. E megjithatë të dyja falimentuan. Për evropianët, më të rëndësishme janë “ndryshimet dhe përmirësimet institucionale”, që kanë të bëjnë me krijimin dhe funksionimin e autoriteteve të rregullimit bankar dhe të tregjeve financiare në nivel evropian, me ndryshimet dhe përshtatjet në kuadrin prudencial (kujdesit), etj.

Debatet dhe filozofia e reformimit të bankave duket se më në fund po kanalizohen në dy tema thelbësore që janë: (1) arkitektura e strukturave

të sistemit bankar dhe (2) rregullat e reja të administrimit të politikës prudenciale.

Arkitektura e re e sistemit bankar po diskutohet në shumë pika: madhësia e bankave, specializimi i bankave dhe qartësimi i roleve, niveli i kapitalizimit, roli i shtetit, etj.

Gjatë 3-4 dekadave të fundit, sektori bankar ka njohur një konsolidim masiv, horizontal e vertikal duke i shumëfishuar përmasat e tij. Shumë prej këtyre grupeve bankare janë bërë tashmë ndërkombëtare. Falimentimi, ose qoftë dhe ecuria problematike e tyre, shkakton kriza të rënda ekonomike, financiare, politike e sociale. Në përmasat e tyre aktuale “gjigante”, ekspozimi i lartë ndaj rrezikut operacional e sistematik e bën çdo falimentim të tyre shumë të dëmshëm për të gjithë sistemin monetar e financiar. Kostot e këtij falimentimi mund të jenë të papërbalueshme edhe ndaj ndërhyrjes publike të qeverive. Sipas



Eshtë koha për kartën tuaj të kreditit!



- **FALAS** për vitin e parë
- Karta në dorën tuaj brenda 3 ditëve
- **0%** për blerje në pikat e shitjes dhe Internet

Apliko ON LINE



Fibank
First Investment Bank

TELEFONONI PA PAGESË NË
0800 01 11

www.fibank.al

Paraja është një pronë dhe një e mirë kolektive që nuk ka për mision të mbështesë pozicionet spekulative të agjentëve financiarë të caktuar dhe as fryrjen e aktiveve në degë e aktivitete, që pastaj përfundojnë në flluska financiare.



shprehjes tashmë të famshme të Nuriel Rubinit: “një bankë “too big to fail” është gjithashtu edhe një bankë “too big to be managed””. Edhe përcaktimi i rolit dhe i prezencës së shtetit, në raport me bankat, mbetet për t’u ripërcaktuar. Kur ato janë në vështirësi shteti duhet të ndërhyjë me kapital, apo t’i shtetëzojë? Duhet vetëm t’i mbështesë, apo thjesht t’i kontrollojë? Arkitektura e re e sistemit bankar kërkon një përcaktim dhe një përkufizim të qartë të madhësisë së lejuar të bankave në të ardhmen.

Specializimi i bankave ose eliminimi i një pjese të aktiviteteve të pastra “spekulative në treg” për një pjesë të tyre, përbën pistën e dytë të reformimit të bankave. Bankat universale, nëpërmjet inovacioneve financiare komplekse, ose produkteve spekulative, në shumë raste ndërmarrin operacione me rrezik të lartë, duke e shtrirë efektin e këtij rreziku tek të gjithë klientët e tyre. Pol Volker shikon te bankat universal, që kryejnë dhe shumë operacione spekulative, mundësinë e një “devijimi të politikave monetare”. Kjo pasi këto banka kanë akses në rifinancimet nga bankat qendrore, e ndërkohë që këtë masë monetare duhet ta përdorin për garantimin e likuiditetit të depozitave dhe për financimin e ekonomisë reale nëpërmjet huave, ato e përdorin atë “për aktivitete të pastra spekulative tregu”. Paraja është një pronë

dhe një e mirë kolektive që nuk ka për mision të mbështesë pozicionet spekulative të agjentëve financiarë të caktuar dhe as fryrjen e aktiveve në degë e aktivitete, që pastaj përfundojnë në flluska financiare. A mund dhe si mund të realizohet një ndarje dhe një specializim i bankave? Zgjidhja e këtij problemi dhe përcaktimi më i saktë i modelit të biznesit të bankave do të përbëjë thelbin e kësaj reforme.

Rregullat e reja të administrimit të politikave prudenciale, sidomos ato që lidhen me likuiditetin, janë bërë edhe më të ashpra në këto vite krize. Për t’u mbrojtur nga rreziku i falimentimit të bankave, një reformë e rëndësishme është dhe marrëveshja e re “Bazel III”, e finalizuar në 16.12.2010, e cila fokusohet tek aktivitetet jashtë bilancit të bankave - sidomos te produktet derivate, te mjaftueshmëria e kapitaleve të tyre në raport me rreziqet në treg, si dhe te rreziku i nivelit të likuiditetit. E parashikuar të hyjë në fuqi në 2013-ën, “Bazel III” përqendrohet te: fiksimi i një niveli të caktuar likuiditeti për bankat; fiksimi i një niveli të dhënë për “efektin levë”; ripërcaktimi i nocionit dhe i përmbajtjes së kapitaleve të vetë bankave; rishikimi i mënyrave dhe i formave të mbulesës së disa lloje rreziqesh, sidomos atyre të lidhura drejtpërdrejt dhe tërthorazi me likuiditetin; si dhe kushtet e apli-

kimit të masave kundraciklike.

Debati aktual për reformimin e bankave dhe të sistemit bankar zhvillohet dhe në një rrafsh tjetër. Modellet e financimit të ekonomive janë të ndryshme në vende të ndryshme. Në Europë për shembull: 70% e financimeve sigurohet nga ndërmjetësimi bankar, ndërkohë që në vendet anglosaksone ky ndërmjetësim garantohej nga tregjet financiare. A mundet që të njëjtat reforma rregullatore të jenë njësoj efektive si për garantimin e stabilitetit financiar, ashtu edhe për garantimin e konkurrencës së barabartë? Zgjidhja, ose përgjigja duket se merr nuanca politike. A duhet privilegjuar hapja dhe liberalizimi financiar kundrejt shtimit të rrezikut të destabilitetit financiar? Nga ana tjetër, ngërçi më i madh në çështjet e rregullimit bankar ndërkombëtar qëndron në fleksibilitetin e vendeve të ndryshme për t’i zbatuar ato. SHBA-ja, që inspiroi rregullat dhe standardet ndërkombëtare të kontabilitetit si dhe rregullat prudenciale në kuadrin e “Bazel II”, nuk i zbatoi kurrë strikt këto rregulla. Europa, që gjithashtu përbëhet nga një heterogjenitet kulturash financiare e monetare nuk po konsolidon dot një grup rregullash bazë, të zbatueshme me rigorozitet nga të gjithë anëtarët e saj. Gjithçka mbetet për t’u përcaktuar në reformat në vazhdim!

1 “shumë e madhe për t’u lënë të falimentojë”.

2 “shumë e madhe për t’u menaxhuar”.

RAIFFEISEN BANK



Raiffeisen Bank sponsorizon Shkollën e muzikës “Prenk Jakova” në Shkodër

Raiffeisen Bank ka sponsorizuar rikonstruksionin e plotë të sallës së koncerteve të shkollës së muzikës “Prenk Jakova” në Shkodër. Gjithashtu në bashkëpunim me Energji Ashta kanë bërë të mundur edhe dhurimin e një pianoje për këtë shkollë në kuadrin e projektit “Mozaik 2011”.

Me këtë rast u organizua një ceremoni inaugurimi në mjediset e kësaj shkolle. Në ceremoni ishte i pranishëm Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Z. Myqerem Tafaj, si dhe Drejtori Ekzekutiv i Raiffeisen Bank, Z. Christian Canacaris, Ambasadori Austriak në Shqipëri, Z. Florian Raunig, përfaqësues të Drejtorisë Arsimore

Rajonale Shkodër, të pushtetit lokal, mësues e nxënës të shkollës, etj.

Pas prerjes së shiritit, nxënësit e shkollës së muzikës “Prenk Jakova” dhanë një koncert, në sallën e re të koncerteve, për të gjithë të pranishmit. Në fund e mori fjalën Drejtori Ekzekutiv i Raiffeisen Bank, Z. Christian Canacaris, i cili u shpreh se ishte shumë krenar që ndodhej në këtë ceremoni inaugurimi dhe në të njëjtën kohë shumë i lumtur që Raiffeisen Bank, me kontributin e saj, bëri të mundur rikonstruksionin e kësaj sale duke ndihmuar në përmirësimin e mjediseve mësimore si dhe në zgjidhjen e nevojave të tyre.

FIBANK

Fibank sponsor i Ditës së Verës në Berat

Fibank ka qenë sponsor i aktivitetit të Ditës së Verës, organizuar në Kalanë e Beratit nga Bashkia e qytetit të Beratit dhe nga Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”. Një koncert argëtues me pjesëmarrjen e këngëtarëve të ndryshëm ishte pjesa kryesore e festimit të Ditës së Verës në këtë qytet. Ky aktivitet pati një fluks të madh pjesëmarrjeje nga qytetarët e Beratit dhe jo vetëm të Beratit. Fibank është aktive dhe ndjek një politikë suportuese ndaj aktiviteteve të tilla kulturore lokale që japin një impakt shumë pozitiv në jetën e qytetarëve.



NBG BANK

NBG Bank mbështeti krijimin e laboratorit të informatikës, kërkimit-shkencor dhe videokonferencës në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës

Laboratori është pajisur me teknologjinë më të fundit e cila do të bëjë të mundur jo vetëm lehtësimin e kërkimeve shkencore nga stafi pedagogjik dhe nga studentët e fakultetit, por edhe kryerjen e leksioneve online me degët e fakultetit në Kukës dhe në Sarandë përmes sistemit modern të videokonferencave.

Në ceremoninë e inaugurimit, ku ishin të pranishëm Rektori i UT-së Dhori Kule, Drejtori i Përgjithshëm i NBG Bank, Ioannis Kougionas, Dekani i Fakultetit Sulo Hadëri, dhe të tjerë e mori fjalën Z., Ioannis Kougionas i cili u shpreh se ishte i nderuar që kishte mundësinë të kontribuonte për Fakultetin e Ekonomisë dhe për sistemin arsimor në Shqipëri.



VENETO BANKA

Veneto Banka dhe Universiteti “Marin Barleti” organizojnë cikël leksionesh: “Komunikimi si problem, burim ose rrezik. Komunikimi si problem kulturor”

Nga datat 19 deri në 23 mars Veneto Banka dhe Universiteti “Marin Barleti” organizuan, me mbështetjen e Institutit Shqiptar të Çështjeve Publike (AIPA), një cikël leksionesh me temë “Komunikimi si problem, burim ose rrezik. Komunikimi si problem kulturor”, mbajtur nga Prof. Dr. Giovanni Bechelloni. Këto leksione synojnë rritjen e ndërgjegjshmërisë për rëndësinë dhe nevojën e komunikimit si mjet i domosdoshëm në kuadrin shoqëror dhe kulturor. Prof. Bechelloni ka një eksperiencë të gjatë dhe të nderuar në universitetet më të mira Europiane.



INTESA SANPAOLO

Punonjësit e Intesa Sanpaolo Bank Albania vizituan Shtëpinë e të Moshuarve me rastin e 8 Marsit

Stafi i Intesa Sanpaolo Bank Albania bëri këtë vit një dhuratë të veçantë për 11 Zonjat që jetojnë në Shtëpinë e të Moshuarve në Tiranë. 11 buqeta me lule, të dhuruara nga Banka me rastin e 8 Marsit dhe 11 zarfe, me një shumë simbolike për secilën prej tyre, mbledhur po në këtë ditë nga kontributi personal i shumë punonjësve të bankës, të cilët donin që edhe këto Zonja të kishin mundësinë

që të shpenzonin për kënaqësinë e tyre me rastin e kësaj feste. Askush nuk meriton të jetojë në vetmi e aq më shumë larg familjes e fëmijëve të tij, ose i braktisur. Të gjithë një ditë do të jemi më të moshuar sesa sot dhe veçanërisht atëherë përkujdesja, dashuria dhe vlerësimi duhen shprehur më shumë se kurrë!



BANKA KOMBËTARE TREGTARE



Vazhdon bashkëpunimi mes BKT-së dhe Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP).

70 studentët e Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP), të përzgjedhur nga BKT-ja si pjesë e kalendarit të tyre mësimor, vazhdojnë të kryejnë praktikën në Drejtorinë e Përgjithshme dhe në degët e ndryshme të BKT-së. Këta studentë, në përfundim të studimeve të tyre, do të kenë mundësinë t'u bashkëngjiten 15 të diplomuarve të parë të këtij Fakulteti, të cilët në ceremoninë e tyre të diplomimit,

kanë nënshkruan kontratat e tyre të punës, duke u bërë automatikisht pjesë e stafit të BKT-së. Programi FASTIP sjell një risi në tregun arsimor në Shqipëri pasi bazuar në këtë program partneriteti biznes-universitet, studentët kanë mundësi që të kryejnë praktikën e tyre të punës në mjediset e institucionit përgjegjës, duke u garantuar në këtë mënyrë edhe punësimin e menjëherëshëm të tyre pas diplomimit.

CREDINS BANK

Dhurata fëmijëve të policëve të rënë në krye të detyrës

Në një organizim modest pranë zyrave të drejtorisë së policisë të qarkut Tiranë, Credins Bank mundësoi, në prani të familjarëve dhe të afërmëve të tyre, shpërndarjen e dhuratave për 40 fëmijët e policëve të rënë në krye të detyrës, në mbrojtje të qytetarit, të rendit dhe sigurisë. Kjo është një nga nismat e bukura dhe një nga mbështetjet e radhës që Credins Bank ofron në kuadër të ndikimit konkret në jetën sociale të vendit.



LAJME NDËRBALLKANIKE

BOSNJE HERCEGOVINA



UniCredit parashikon përmirësimin e raportit të kredive me probleme të bankave të Bosnjës në 7.7% në vitin 2012

Seenews.com 25 janar 2012

Raporti i kredive me probleme në sistemin bankar të Bosnjës pritet të përmirësohet në 7.7% këtë vit nga 13.3% që ishte në vitin 2011 dhe me një rënie të mëtejshme, në një periudhë afatmesme, në më pak se 4%, shprehet UniCredit në një përmbledhje mbi tregun dhe industrinë bankare në Europën Qendrore dhe Lindore (CEE). Dinamikat e kredive me probleme në Bosnjë janë subjekt i disa mospërputhjeve metodologjike, që rrjedhin nga aplikimi i diferencuar i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe prej raportimit financiar në dy njësitë e saj përbërëse: Federata Myslimano-Kroate dhe Republika Serbe. Kjo ka çuar, sipas deklaratimit të grupi bankar italian, në rritjen relativisht më të ngadaltë të kredive me probleme në vitin 2011, në parashikimin bankar të prezantuar në janar.

BULLGARIA



Depozitat bankare të Bullgarisë arritën rekordin më të lartë prej 31.9 miliardë BGN

Novinite.com 2 shkurt 2012

Bankat në Bullgari kanë regjistruar rritje të qëndrueshme dhe të ndjeshme të depozitave përgjatë vitit 2011, tendencë kjo e cila kulmoi në tremujorin e fundit të vitit, siç e tregojnë të dhënat e Bankës Qendrore. Depozitat e bullgarëve në bankat lokale u rritën me 768 milionë BGN vetëm gjatë dhjetorit të vitit të kaluar, kështu raportuan agjencitë e lajmeve duke cituar Bankën Qendrore. Shuma e përgjithshme e depozitave arriti në fund të vitit 2011 rekordin më të lartë prej 31.9 miliardë BGN, duke shënuar një rritje vjetore me 21% nga viti 2010.

Bankat e huaja tërheqin fonde nga degët e tyre në Bullgari

Business New Europe 2 shkurt 2012

Bankat e huaja po tërheqin fonde nga degët e tyre në Bullgari, ndërkohë që rritja e kreditimit në vend është frenuar, siç njoftuan mediat vendase duke u bazuar në të dhënat paraprake nga Banka për Rregullimet Ndërkombëtare (BIS). Ekspozimi i përgjithshëm i



bankave të huaja në Bullgari arriti në 2.3 miliardë USD gjatë tremujorit të tretë të vitit të kaluar dhe rreth gjysma e tij - 1 miliardë USD - u tërhoq nga bankat greke, raportoi e përditshmja *Sega*. Bankat greke zënë rreth 30% të tregut bankar bullgar, rreth 20% të kredive bankare dhe një të tretën e të gjitha depozitave.

KROACIA



Banka Qendrore e Kroacisë shtrëngon likuiditetin

Reuters 30 janar 2012

Banka Qendrore e Kroacisë është e gatshme të shtrëngojë më tej likuiditetin në vend sesa të rrezikojë pakësimin e rezervave të saj për të mbrojtur monedhën Kuna, tha në një intervistë Guvernatori Zeljko Rohatinski. Kriza e borxhit në Eurozonë po kërcënon praktikisht frenimin e hyrjeve të kapitalit të huaj në sektorin bankar të Kroacisë, çka do të rriste shpenzimet e rifinancimit për bankat, për bizneset dhe për qeverinë, tha Rohatinski. Kuna shënoi këtë muaj nivelin më të ulët që prej shtatë vitesh, duke reflektuar rënien e flukseve hyrëse në monedhë të huaj, eksporte të dobëta dhe shlyerjen e borxhit të kompanive vendase ndaj kreditorëve të huaj.

Fitimi bruto i bankave të mëdha në Kroaci në vitin 2011 u rrit me 10%

Balkans.com 16 shkurt 2012

Të gjitha bankat e mëdha në Kroaci, duke përfshirë bankat e grupeve UniCredit dhe Intesa, shënuan rritje të fitimeve të tyre bruto gjatë vitit 2011 me 10% më shumë sesa në vitin e kaluar. Sipas shifrave më të fundit, sektori bankar pati një total të ardhurash bruto prej 626 milionë EURO, 53 milionë EURO më shumë sesa në vitin 2010. 24 nga 32 bankat që janë aktive në tregun kroat, e mbyllën vitin me fitim, ndërsa tetë banka të vogla regjistruan humbje dhe një bankë u detyrua të mbyllej.

GREQIA



Depozitat në bankat greke rriten me 0.8% në dhjetor

Reuters 30 janar 2012

Depozitat bankare të biznesit dhe të individëve grekë u rritën me 0.8% në muajin dhjetor, duke ndërprerë rënien e tyre të qëndrueshme përgjatë vitit 2011, kështu raportoi Banka Qendrore e vendit. Të dhënat e Bankës së Greqisë treguan një rritje të depozitave në 174.23 miliardë EURO (228 miliardë USD) në dhjetor, nga 172.89 miliardë EURO një muaj më parë.

Bankat greke mund të mos kenë nevojë për të gjithë ndihmën nga BE/FMN

Reuters 17 mars 2012

Bankat greke mund të mos kenë nevojë për të gjithë ndihmën e premtuar nga BE-ja dhe FMN-ja për të kaluar krizën, citohet të ketë thënë Guvernatori i Bankës Qendrore George Provopoulos. Bashkimi Europian dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar kanë vënë mënjanë rreth 50 miliardë EURO për të rikapitalizuar dhe për mbështetur huadhënësit, mbajtësit më të mëdhenj privatë të borxhit të Greqisë. Rikapitalizimi i bankave do të përfundojë deri në shtator të 2012-ës, dhe shuma në dispozicion nuk do të ketë nevojë të shterohet plotësisht, tha Provopoulos për gazetën Vima.

Provopoulos pohoi se ai ende shpreson se do të ketë shkrirje bankash në sektorin bankar grek, pasi Alpha Bank deklaroi se nuk do të bashkohej me Eurobank, që po të ndodhte, do të kishte qenë shkrirja më e madhe e bankave që ka ndodhur prej dekadash në Greqi.

KOSOVA



Kosova nis emetimin e letrave me vlerë

Banka Qendrore e Kosovës 17 janar 2012

Sot, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës me sukses ka shitur në ankand konkurrues bono thesari 3-mujore të Republikës së Kosovës në vlerë prej 10 milionë

Euro. Bonot e thesarit, të cilat maturohen më 18 prill 2012, janë shitur me normë kthimi prej 3.5%. Ankandi kishte më shumë oferta sesa shuma e shpallur nga Ministria e Financave, respektivisht ofertimi arriti vlerën 22.5 milionë Euro. Ankandi i sotëm ishte një ngjarje historike për Republikën e Kosovës, pasi paraqet për herë të parë emetimin e Letrave me Vlerë të qeverisë. Këto shuma do të përdoren për investime kapitale në buxhetin e shtetit. Ky ankand është i pari nga ankandet e planifikuara të bonove të thesarit përgjatë vitit 2012. Ministria e Financave do të lëshojë në total 74 milionë Euro në letra me vlerë këtë vit.

Kosova mund të nënshkruajnë Paktin me FMN-në gjatë krizës së borxhit

Reuters 22 mars 2012

Kosova mund të përmbyllë në fund të qershorit një marrëveshje ndërkombëtare mbështetjeje me vlerë rreth 110 milionë EURO (145 milionë USD), si një mbrojtje ndaj krizës së borxhit në Europë, tha Guvernatori i Bankës Qendrore Gani Gërguri. Kosova, e cila shpalli pavarësinë nga Serbia katër vjet më parë, duhet ende të bjerë dakord për shumën e saktë të marrëveshjes. Ajo iu drejtua për herë të parë Fondit Monetar Ndërkombëtar në vitin 2010 pasi u bë anëtarja e 186-të e Fondit me qendër në Uashington. Deri tani, ndihma nuk ka qenë e nevojshme pasi ekonomia pritet të ketë një rritje prej 3.8% këtë vit, tha Gërguri, edhe pse pritshmëria për rritje u rishikua nga 5% që ishte parashikimi.

MALI I ZI



Sektori bankar i Malit të Zi ka filluar të shohë rezultate pozitive

Balkans.com 28 shkurt 2012

Pas një periudhe të gjatë kohe, sektori bankar i Malit të Zi ka filluar të shohë rezultate pozitive; kapitali, likuiditeti dhe aftësia e tij paguese janë në nivele të kënaqshme, deklaroi Shoqata e Bankave të Malit të Zi, duke shtuar se testimi që po kryhet për situatat e stresit do të përfundojë me sukses. Sekretari i Përgjithshëm i Shoqatës, Mirko Radonjic, tha për agjencinë "Mina-business" se Banka Qendrore kishte bikëqyrrur dhe analizuar vazhdimisht situatën në këtë sektor, duke kryer analiza "stress test" kur është parë e nevojshme, për të vijuar ruajtjen e stabilitetit të sistemit bankar.

Bankat e Malit të Zi kanë potencial për rritjen e mëtejshme të kapitalit të tyre

Balkans.com 19 mars 2012

Rezultatet e analizave "stress test" kanë treguar se, pavarësisht indeksit të qëndrueshëm të aftësisë paguese, ka potencial për rritje të mëtejshme të kapitalit të disa bankave të Malit të Zi, në mënyrë që të sigurohet stabiliteti i tyre i plotë në rast të goditjeve të jashtme makroekonomike. Banka Qendrore e Malit të Zi ndërmori, në bashkëpunim me Bankën Qendrore Europiane, kryerjen e një analize "stress test" të bankave, duke filluar nga rezultati i agreguar në nivel sistemi, deri te rezultati për secilën bankë.



Vlerësojmë mbështetjen tuaj

Dega Toptani dhe Head Office

Rruga "Murat Toptani"

(Eurocol Center)

Tirane Albania

Tel: 4 2256 254 / 2254 372 / 2235 406

Fax: 4 2235 409 / 2254 368

Email: toptani@icbank-albania.com

Themeli i një sipërmarrje është besimi. Për 15 vite, ju, klientët tanë keni besuar në vizionin tonë për vlerat bankare. Ambicja dhe angazhimi ynë në vlera të shkëlqyera bankare bazohet në parimet e Besimit, Përballueshmërisë, Thjeshtësisë dhe Transparencës. Vlerësojmë mbështetjen tuaj duke drejtuar sipërmarrjen tonë me integritet dhe profesionalizëm dhe do të vazhdojmë të ndjekim vizionin e vlerave bankare duke krijuar platforma me produkte dhe shërbime, të cilat vendosin ju, klientët tanë, në plan të parë



MAQEDONIA



Fitch e konfirmon vlerësimin "BB +" për Maqedoninë

Agjencia Maqedonase e Informacionit 26 mars 2012

Agjencia Fitch Rating sipas klasifikimeve të bëra në faqen e saj në internet i jep vlerësimin "BB +" Maqedonisë, me një parashikim të qëndrueshëm. Sipas një analize, të bërë po nga kjo agjenci rreziqet politike, duke përfshirë edhe diskutimet mbi çështjen e emrit dhe mbi vonesat që vijnë si pasojë e tyre në bisedimet e pranimit në BE, janë faktorë negativë në vlerësim. Zgjidhja e çështjes për emrin, që do hapte rrugën drejt anëtarësimit në BE, me përfitimet që do të kishte në drejtim të institucioneve dhe drejt kornizave politike më të forta si dhe qasje më të mira ndaj financimit, investimeve dhe tregjeve të eksportit, mund të mbështeste një rritje të vlerësimit, nëse do të shoqërohej nga një rritje ekonomike e mjaftueshme.

Maqedonia shet obligacione prej 676.9 milionë Dinarë (11 milionë EURO)

Seenews.com 26 mars 2012

Maqedonia shiti obligacione qeveritare pesëvjeçare me vlerën totale prej 676.9 milionë Dinarë (14,5 milionë USD ose 11 milionë EURO) në dy ankande gjatë javës së shkuar, sipas raportimit të Bankës Qendrore. Sipas një deklarate të bërë javën e kaluar po nga Banka Qendrore Ministria e Financave shiti obligacione pesëvjeçare me vlerë 424.4 milionë Dinarë, me një kupon vjetor prej 5.7 %.

RUMANIA



Raporti i kredive me probleme arrin në 14% në vitin 2011

Business New Europe 30 janar 2012

Raporti i kredive me probleme, për të gjithë sistemin e institucioneve të kreditit të regjistruara në Rumani, arriti në 14.18% në fund të tremujorit të tretë të vitit 2011, krahasuar me 11.67%, më 30 shtator të 2010-ës, kështu raporton agjencia Agerpres bazuar në të dhënat e publikuara nga Banka Kombëtare e Rumanisë.

Banka Qendrore e Rumanisë ul normat e interesit në një nivel minimal rekord

Balkans.com 3 shkurt 2012

Banka Qendrore e Rumanisë i uli normat e interesit në rekordin më të ulët, duke përforcuar më tej mbështetjen e saj për një ekonomi të brishtë, me shpresën që masat e ashpra të qeverisë, në lidhje me financat publike, nuk do të përkthehen në pengesa për investitorët nga rënia në të ardhurat e tyre. Ekonomia e Rumanisë u kthye përsëri me një ecuri në rritje prej rreth 2.5% vitin e kaluar, por po merr ende veten nga goditja e tkurrjes prej më shumë se 8% në vitin 2009 dhe 2010, duke nxitur Bankën Qendrore të ulë koston e huamarrjes deri në 5.5%.

SERBIA



Qeveria e Serbisë planifikon të mbetet aksionari më i madh i Bankës Komercijalna

Balkans.com 30 janar 2012

Qeveria serbe planifikon të mbetet aksionari i vetëm më i madh i Bankës vendase Komercijalna në të ardhmen e afërt, këtë raportuan mediat e Beogradit. Për këtë qëllim, qeveria këtë vit planifikon një rritje të kapitalit në Bankën Komercijalna prej 110 milionë EURO. Serbia zotëron 42.59% të kapitalit të Bankës Komercijalna, ndërsa aksioneri i dytë më i madh është Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim me 25% të kapitalit.

Banka Kombëtare e Serbisë mban normën bazë të interesit në 9.5%

Business New Europe 9 mars 2012

Agjencitë e lajmeve raportuan se Banka Kombëtare e Serbisë më 8 mars vendosi për mbajtjen e normës vjetore të interesit në 9.5%. Banka tha se norma bazë e interesit u mbajt në të njëjtin nivel për shkak të faktorëve të inflacionit me efekt në afatin e mesëm, të tillë si kërkesa e ulët, çmimet e importit në rritje, rreziqet ndërkombëtare dhe politika fiskale. Më 19 janar të vitit 2012, Bordi Ekzekutiv i Bankës Kombëtare të Serbisë (NBS) reduktoi normën me 25 pikë bazë në 9,5%. Kjo ishte ulja e shtatë e normës bazë pasi NBS-ja kishte vendosur të relaksonte politikën monetare në qershor të vitit 2011.

TURQIA



Bankat turke po arrijnë një rekord të rritjes së shitjeve të obligacioneve këtë vit

Balkans.com 21 shkurt 2012

Bankat turke po rrisin shitjet e obligacioneve duke arritur një rekord këtë vit, në mbështetje të rritjes së kreditimit për të mbrojtur ekonominë nga rënia. Vetëm dy vjet më parë, bankat nuk po shisnin asnjë obligacion. Të dhënat e përpiluara nga Bloomberg tregojnë se deri tani, në vitin 2012, janë emetuar rreth 4 miliardë USD, katër herë më shumë se një vit më parë. Akbank TAS, banka më e madhe për nga vlera e tregut, tha në 17 shkurt se do të trefishojë vlerën e shitjes së vetme të obligacioneve në valutë në vitin 2011, në shumën prej 1.5 miliardë USD. Turkiye Garanti Bankasi AS, banka e dytë për nga huadhënia, emetoi muajin e kaluar obligacione lokale në shumën 1 miliard lira (600 milionë USD), me normë kthimi 11%.

Rritja e huadhënies bankare në Turqi ngadalësohet në më pak se 26% në vit.

13 shkurt 2012 - Reuters

Rritja e tepërcës së huave nga bankat turke u ngadalësua tek një shifër më pak se 26 për qind nga shkurti i vitit të kaluar, duke dënë shenja të një ngadalësimi gradual ekonomik, pas një viti të karakterizuar nga një politikë monetare joortodokse, nga ana e bankës qendrore, me synim parandalimin e "nxehjes" së ekonomisë. Shifrat ishin shumë më të larta sesa ato prej 10 për qind, të raportuara nga guvernatori i bankës qendrore, z. Erdem Basçı, gjatë muajit të fundit, duke mos qenë kështu drejtpërdrejt të krahasueshme.

PAGESAT ME CELULAR - METODË ALTERNATIVE PAGESASH



nga Linda SHOMO
Administratore
EASYPAY

Zhvillimet e shpejta teknologjike ndikojnë shumë në mënyrën e jetesës së individëve dhe në praktikën e biznesit. Interneti dhe kompjuterët kanë ndikuar ndjeshëm veçanërisht në praktikën e marketingut, por edhe telefonat lëvizës (celularë) kanë treguar që kanë një potencial po aq të madh, tashmë si pasojë e popullaritetit dhe përdorueshmërisë në jetën e përditshme të individëve. Ndërkohë që industria e telekomunikacionit ka penetruar tregun shqiptar në afërsisht 140 për qind, sektorit bankar i mbeten ende segmente të tregut për të mbuluar. Vërehet se pak banka kanë qenë aktive në ofrimin e shërbimeve për të tërhequr atë pjesë të tregut që njihet si “unbanked”. Pikërisht, për këtë arsye institucione të ndryshme financiare jobanka në Shqipëri kanë ndërmarrë nisma për të mbuluar këtë hapësirë me shërbime si: pagesat me celular dhe pagesat me internet. Aparatët celularë kanë mundësuar lehtësimin e sistemit të pagesave dhe transfertave edhe për ata që nuk janë klientë të bankave. Nga ana tjetër, mjedisi ofron vështirësi dhe pasiguri, për një zhvillim të kënaqshëm të këtij sektori në Shqipëri.

Sfidë kryesore mbetet integrimi me sistemin bankar shqiptar, pasi është e rëndësishme që bankat të kuptojnë fuqinë e prezantimit të shërbimeve dhe teknologjive të reja.

Një vështrim mbi industrinë e pagesave me celular

Telefonat celularë kanë potencial të madh në transformimin e mënyrës së kryerjes së pagesave dhe transfertave. Përdorimi i kartave të debitit dhe kreditit po rritet në Shqipëri, çka tregon se konsumatorët finalë preferojnë të kryejnë pagesa të ndryshme shpejt e me kosto të ulëta. Pagesat me celular i japin këtij segmenti tregu edhe më shumë fleksibilitet, duke i mundësuar pagesat për çdo gjë, në çdo vend dhe në çdo kohë. Në parantezë, duhen qartësuar dy koncepte që shpesh krijojnë konfuzion midis tyre: Pagesat me Celular (Mobile Payments) dhe Bankingu me Celular (Mobile Banking).

Pagesat me celular janë pagesa (transferim fondesh në këmbim të një malli ose shërbimi) ku celulari është i përfshirë në procesin e inicimit dhe në procesin e konfirmimit të pagesës.

Bankingu me celular është aksesimi i shërbimeve bankare nëpërmjet celularit. Kjo përfshin një pjesë ose të gjitha shërbimet që ofrohen nga banka nëpërmjet internetit në formën e “online banking”.

Pagesat me celular, për një sërë arsyesh janë mjaft atraktive për shumë aktorë tregu:

Institucionet financiare kanë mundësi të depërtojnë nëpërmjet këtyre pagesave në segmente të paplotësuara nga tregu bankar. Së dyti, operatorët e telefonisë celulare mund të

shtojnë gamën e shërbimeve të ofruara, duke diversifikuar portofolin e produkteve si dhe duke iu afruar nevojave të konsumatorëve dhe mënyrave të tyre të reja të jetesës. Së treti, tregtarët kanë mjaft avantazhe në pranimin e pagesave me celular nga klientët e tyre, duke përshpejtuar mënyrën e kryerjes së transaksioneve, duke zgjeruar rrjetin e tyre të shpërndarjes, kapjen e tregjeve të reja, uljen e nevojës për të mbajtur para¹ në arkë dhe rrjedhimisht mundësinë e vjedhjeve, etj. Së katërti, të rinjtë, si një segment i rëndësishëm i tregut, janë më komodë në përdorimin e celularit dhe të internetit, për të kryer një sërë veprimesh njëherazi.

Një vështrim analitik mbi këtë industri në botë do të hidhte pak dritë mbi pritshmëritë e ofruesve të pagesave me celular në Shqipëri.

Ekzistojnë disa modele biznesi në sektorin e pagesave me celular. Menaxhimi i tyre mund të kryhet si nga një operator i vetëm, ashtu edhe nga bashkëpunimi i një grupi operatorësh nga industri të ndryshme, p.sh. banka dhe telekomunikacioni, duke i siguruar në këtë mënyrë vlerë të gjithë sistemit. Ndër modelet e biznesit të aplikuar deri më tani veçohen: sistemi i centralizuar tek bankat; i centralizuar tek operatorët celular; ose i ofruar nga palë të treta, të pavarura, që sigurisht janë të licencuara për këto lloj shërbimesh. Rasti i shoqërisë amerikane “Obopay” është shembull

¹ E pambuluar me shërbim bankar.

...mbetet ende shumë për të bërë nga bankat shqiptare, që të hyjnë në botën e e-commerce dhe të investojnë bindshëm në këtë fushë.

li i një sistemi pagesash të ngritur me sukses nga një institucion financiar i pavarur. Ndërkohë, shoqëria spanjolle "Mobipay" dhe ajo "M-Pesa" në Kenia janë raste të bashkëpunimit të suksesshëm të disa operatorëve.

Më të suksesshme deri tani, në vende të ndryshme të botës, kanë rezultuar modelet e ngritura nga institucionet e pavarura që bashkëveprojnë me sistemin financiar dhe me telekomunikacionin, dhe bëjnë të mundur përdorimin e këtyre shërbimeve nga shumica e popullsisë

Një sfidë e rëndësishme për zhvillimin e pagesave me celular dhe pagesave në internet është kuadri rregullator për këtë sektor. Në disa vende, mungesa e rregulloreve kthehet në kërcënim kryesor për ofruesit e këtij shërbimi. Në mënyrë të rëndësishme, vendosja e një sistemi rregullator për këtë industri do të mbronte fillimisht konsumatorët, do të monitoronte dhe do të mbante nën kontroll rrezikun dhe gjithashtu do të siguronte stabilitet e transparencë mes palëve. Njëkohësisht, që ky sektor të zhvillohet me ritme të shpejta, nevojitet që barrierat hyrëse për operatorët e rinj të jenë të ulëta.

Nevojat e konsumatorit duhet gjithashtu të merren parasysh nga operatorët e këtyre pagesave. Barrierat psikologjike lidhur me ndryshimet në sjelljet e deritanishme të konsumatorëve duhet të analizohen me shumë seriozitet. Një "shoqëri e parasë fizike", mund ta ketë shumë të vështirë të ndryshojë krejt mënyrën e kryerjes së transaksioneve. Në fakt, ofruesit e sistemit të ri të pagesave duhet të mbështeten shumë në strategjitë e marketingut për të identifikuar segmentet e tregut që do të ishin të gatshme të ndryshonin sjelljet dhe të adoptonin metodat e reja, e më pas të fokusohen në edukimin e tij me teknologjinë e re.

Pavarësisht potencialit që industria e pagesave me celular premton, duhet pranuar se zhvillimet e pagesa-

ve me celular nuk janë të suksesshme në të gjithë botën njësoj. Shanset më të mëdha janë në vendet në zhvillim, aty ku penetrimi i operatorëve celular është i konsiderueshëm dhe potenciali për të zhvilluar këto sisteme pagesash është i lartë si pasojë e një infrastrukturë më pak të zhvilluar të sistemit bankar.

Sfidat e sistemit financiar shqiptar në lidhje me paranë elektronike dhe sistemet e reja të pagesave

Siç ndodh edhe në tregjet ndërkombëtare, EasyPay ka hasur pengesa në futjen e këtyre pagesave në një treg të ri dhe të vështirë siç është Shqipëria. Eksperiencia e deritanishme ka treguar se disa nga vështirësitë më të mëdha janë edukimi i tregut, integrimi me sistemin bankar dhe lufta me informalitetin.

Bankat duhet të kuptojnë fuqinë e prezantimit të shërbimeve dhe teknologjive të reja, sidomos kur këto ofrohen nëpërmjet institucioneve të licencuara për këto shërbime. Përgjithësisht, mbetet ende shumë për të bërë nga bankat shqiptare, që të hyjnë në botën e e-commerce dhe të investojnë bindshëm në këtë fushë. Bankat gjithashtu duhet të marrin parasysh kërkesat gjithnjë në rritje të biznesit për hapje llogarish (merchant accounts) dhe shitje në internet, si dhe kërkesat po ashtu në rritje të klientëve për blerje me karta krediti në internet. Kërkesë aktuale e tregut shqiptar është edhe mundësia e integritit të sistemit bankar shqiptar me operatorët lider në botë në fushën e pagesave, siç është PayPal, si dhe mundësia, në një të ardhme të afërt, për të pranuar edhe monedhën shqiptare në sistemin e tyre të pagesave.

Një tjetër sfidë por dhe mundësi është bashkëpunimi i operatorëve VISA dhe MASTERCARD me institucionet financiare jobanka, të licencuara në fushën e pagesave. Ky lloj bashkëpunimi do t'i jepte një mbështetje të fuqishme ndërveprimit midis këtyre institucioneve, si dhe do të rriste vëllimin e transaksioneve me karta.

Në mbyllje, ndryshimet e fundit në legjislacion, lidhur me paranë elektronike janë një mbështetje e fortë për sektorin e pagesave me celularë dhe në internet në Shqipëri, por që duhet të ndiqet nga përshtatja e rregulloreve specifike të këtij sektori, në përputhje me direktivat e fundit të BE-së për pagesat.



EASYPAY i pari operator shqiptar që mundëson pagesat me celular dhe Internet në Lekë

EasyPay u licencua nga Banka e Shqipërisë në 21.12.2009, për të ushtruar veprimtari financiare të shërbimit të pagesave dhe transferimit të parasë, dhe në shtator të vitit 2010 ishte i pari operator pagesash që ofronte pagesa në Lekë me celular dhe në internet. EasyPay është i pari tregtar shqiptar që shet abonimet e Digitalb me PayPal në internet. Volumi i transaksioneve ka qenë i kënaqshëm duke marrë parasysh periudhën e shkurtër të veprimtarisë në treg dhe vështirësitë e tregut shqiptar. Volumi i pagesave të ofruara deri më sot nga EasyPay është mbi 200 milion lekë dhe shërbimet e ofruara ofron shtohen dita ditës. Bashkëpunimi me kompanitë më të mëdha në vend konsiderohen si pikat më të forta të suksesit. Deri më sot EasyPay ofron një sërë shërbimesh si:

1. Abonim të paketave Digitalb: me SMS dhe ONLINE
2. Rimbushje të numrave PLUS
3. Pagesa online në Internet për biznese të ndryshme
4. Pagesa faturash
5. Blerje të biletave për Bingo 7
6. Transaksione të tjera si:
 - a) Credit Transfer (P2P)
 - b) Kontroll balance të llogarisë
 - c) Lista e veprimeve të kryera
 - d) Ndërrimi i PIN

FINANCIMI I PROJEKTEVE

Financimi i projekteve përfaqëson një mënyrë më eficiente të shpërndarjes së rrezikut dhe kthimit, krahasuar me strategjitë konvencionale të financimit. Ajo bën të mundur që huamarrësit të sigurojnë financim të lidhur ekskluzivisht me karakteristikat e projektit dhe të shkëputur nga flukset e tjera të arkës të sponsorit.

Financimi i projekteve është një metodë e organizimit dhe financimit të projekteve të investimeve që kërkojnë kapital të madh. Megjithatë ai nuk është ndonjë zbulim i financave moderne, zbatimi i tij u rrit e kapi majat e inovacionit gjatë viteve '80 dhe '90, pasi u përdor si mënyrë për të financuar projekte madhore, si: minierat, ndërtimin e supercisternave, rrugëve, urave e madje, parqeve argëtuese. Risia, fuqia dhe kompleksiteti i kësaj metode financimi shpesh ka zbehur thjeshtësinë e saj ekonomike. Financimi i projekteve përfaqëson një mënyrë më eficiente të shpërndarjes së rrezikut dhe kthimit krahasuar me strategjitë konvencionale të financimit. Ata që kanë aftësi të veçanta të përballojnë dhe marin përsipër lloje të veçanta rreziqesh të projekteve shpërblehen për këtë. Rezultati është kosto më e ulët e financimit, eliminimi i humbjeve nga rritja e taksave si për konsumatorët ashtu dhe për investuesit si dhe thjeshtë përfundimi i suksesshëm i projekteve, të cilët nuk mund të ndërmerren dhe realizohen në forma të tjera.

Dy fjalë mbi financimin e projekteve
Financimi i projekteve mund të karakterizohet nga disa apo të gjitha cilësitë e mëposhtme:

- Krijohet një subjekt juridik i veçantë (dmth i shkëputur nga organizata mëmë, që kërkon ndërmarrjen e këtij investimi), që angazhohet për zbatimin e projektit. Ky subjekt mund të organizohet në formën e një ortakërie apo shoqërie.
- Subjekti themelohet mbi bazën e një biznesi apo aktiviteti të veçantë, i cili është i ndashëm nga sponsori ose shoqëria mëmë, e me shumë gjasa, ka një jetë (ekonomike) të fundme (të përcaktuar). Projekti duhet të

ketë objektiva të qarta dhe sigurisht një rezultat (përfundim) të tillë. Financimet e projekteve, përgjithësisht janë të shtrenjtë për t'u filluar dhe realizuar. Kontratat me këtë rast, duhet të përshkruajnë në detaje përgjegjësitë, kontributet dhe përfitimet e pjesëmarrësve të ndryshëm në projekt. Kontabilizimi dhe sistemet e monitorimit të tyre kërkojnë gjithashtu shuma të konsiderueshme fondesh.

- Financimi i projekteve mund të përfshijë lloje të ndryshme aktivesh dhe operacionesh. Zakonisht, ato kategorizohen në dy grupe të mëdha:

- Projekte të tipit të shfrytëzimit të rezervave. Këto projekte varen nga ekzistenca e një rezerve të mjaftueshme malli apo pasurie për t'u shfrytëzuar, të ardhurat nga e cila përdoren për shlyerjen

e kreditorëve si dhe ofrojnë kthim (fitim) për investuesit. Si shembuj të këtij tipi financimi të projekteve mund të përmenden: minierat e të gjitha llojeve, fushat e naftës dhe të gazit, etj. Ky tip projekti përfundon me mbarimin e rezervës së pasurisë në fjalë.

- Projekte të tipit rrjedhës. Këto projekte varen nga një fluks i caktuar biznesi apo trafiku gjatë jetës së projektit, me qëllim që të sigurojë fondet për shlyerjen e kreditorëve si dhe t'i ofrojë një kthim (fitim) të caktuar investuesve. Shembuj të tillë përfshijnë: naftësjellësit dhe gazsjellësit, urat me pagesë, autostradat me pagesë, tunelet, supercisternat, hidrocentralet, hotelet dhe parqet e argëtimit. Ky tip projekti përfundon me amortizimin e ndërtimit apo pajisjeve respektive.

PËRSE REKOMANDOHET FINANCIMI I PROJEKTEVE?

Meqenëse teknologjitë e pastra dhe produktet e tjera të shëndetit janë provuar si komercialisht të qëndrueshme e të besueshme (rrezik i ulët dhe kthim relativisht i lartë), ato e kanë rritur popullaritetin në sytë e investuesve që nuk parapëlqejnë rrezikun e lartë dhe tek menaxherët e fondeve në mbarë botën. Kapitali i investuar në sipërmarrje me rrezik të lartë, mbetet burimi kryesor për risitë në teknologji dhe për krijimin e vendeve të reja të punës. Por në ekonominë aktuale, financimi i projekteve, veçanërisht në vendet në zhvillim vazhdon të jetë:

- Një mënyrë për ruajtjen e pronësisë së partnerëve ekzistues dhe investuesve të rinj – financimi me hua ruan kapitalin e pronarëve, ndërkohë që shpërndan kapitalin e nevojshëm me kosto të arsyeshme.
- Burim i vendeve të punës, që ndihmojnë në luftimin e varfërisë;
- Një mënyrë e fuqishme dhe e qëndrueshme për të mbrojtur burimet e çmuara natyrore;
- Një forcë lëvizëse për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe cilësi më të mirë jete;
- Një mekanizëm për sigurimin e "tregut të lirë dhe të hapur", jo i mbështetur në ndihma, stimul që shtrembërojnë tregun e lirë apo politika manipuluese – si dhe një rrugë e qëndrueshme për një mjedis më të pastër dhe një shoqëri më të mirë.


Palët në financimin e projekteve

Diagrama e mëposhtme ilustron marrëdhënien midis palëve kryesore pjesëmarrëse në financimin e projekteve, si dhe marrëveshjet respektive, që qeverisin marrëdhëniet mes tyre. Nëse një autoritet publik synon të ofrojë një shërbim publik nëpërmjet sektorit privat dhe financimit të investimit po nga sektori privat, atëherë kjo mund të bëhet nëpërmjet Partneritetit Publik-Privat (PPP). Shumë shpesh, në një PPP, për shembull: për rrugët me pagesë, shoqëria e projektit ndërton, zotëron dhe shfrytëzon infrastrukturën si dhe përdor strukturën e financimit të projekteve, për të financuar investimin kapital. Sektori privat, në këtë rast, mund të kompensohet nga përdoruesit e rrugës, ose nga kombinimi i atyre që u përmendën më lart.

III. Financimi i projekteve kundrejt financimit të shoqërive (bizneseve)

Alternativa e krijimit të një shoqërie të veçantë për projektin, e cila duhet të sigurojë fonde për zhvillimin e projektit, është që shoqëria të realizojë dhe financojë projektin nëpërmjet bilancit të saj. Disa nga dallimet midis dy tipeve të financimit paraqiten si vijon:

- Financimi i shoqërive (biznesit) është i përshtatshëm për projekte me vlerë më të vogël, ndërkohë që financimi i projekteve është më i përshtatshëm për projekte të mëdha;
- Financimi i shoqërive (biznesit) është i përshtatshëm në rastet kur shoqëria është e fortë dhe relativisht e madhe, krahasuar me projektin;



- Transaksionet për financimin e shoqërive (biznesit) mund të rregullohen e të përfundojnë shumë më shpejt, krahasuar me financimin e projekteve, transaksionet dhe negociatat për të cilat mund të zgjasin me vite;
- Huaja për projektin zakonisht është më e shtrenjtë sesa huaja në rastin e financimit të shoqërive (biznesit);
- Disiplina në financimin e projekteve është më e fortë sesa disiplina respektive në rastin e financimit të shoqërive (biznesit);
- Financimi i shoqërive (biznesit) përdor më shumë lloje huash. Historikisht, financimi i projekteve identifikohet me huanë bankare, por kjo po ndryshon shpejt në

favor të rritjes së përdorimit të obligacioneve, në kuader të financimit të projekteve;

- Huatë për financimin e projekteve kanë probabilitet më të vogël mosshlyerje, si dhe norma të larta rekuperimi, krahasuar me huanë në rastin e financimit të shoqërive (biznesit). Investimet e kryera nga financimi i shoqërive (biznesit) e ekspozojnë firmën sponsorizuese ndaj humbjeve deri në koston totale të projektit, ndërkohë që investimet në rastin e financimit të projekteve e ekspozojnë firmën ndaj humbjeve jo më të mëdha sesa vlera e kapitalit të vet;
- Financimi i projekteve e mbron bilancin e shoqërisë;
- Për bankat, financimi i projekteve kërkon më pak kapital rregullator;
- Shoqëria e projektit ofron mundësinë e krijimit të një strukture të re menaxhuese, sipas natyrës së veçantë të aktiveve të saj, për të menaxhuar konfliktet midis pronësisë dhe kontrollit si dhe mes pronarëve dhe palëve të tjera të lidhura, të tillë si furnitorët, etj. Në rastin e financimit të shoqërive, aktivet dhe flukset e arkës do të menaxhoheshin nga strukturat ekzistuese të shoqërisë;
- Natyra e projektit, e fokusuar në një aktiv specifik, e bën më transparente ecurinë e projektit. Në kontrast me të, shoqëritë huamarrëse shpesh kanë rrjedha të ndryshme të ardhurash, struktura të komplikuar filialesh dhe praktikash kontabël si dhe rrjedha të parasë, të vështira për t'u analizuar.



përgatitur nga Junida TAJA, AAB

**APLIKO
TANI**



TË ËNDËRROSH PËR SHTËPINË TËNDE TË RE DO TË THOTË TË ËNDËRROSH PËR NJË TË ARDHME MË TË SIGURT PËR FAMILJEN TËNDE

Prandaj kemi zgjedhur kredinë për shtëpi të Banka Intesa Sanpaolo

SEPSE NA PËLQEN TA PROJEKTOJMË VETE TË ARDHMEN TONË

 **INTESA SANPAOLO BANK**

Drejt të ardhmes me ju.



VEPRIMTARITË e Shoqatës Shqiptare të Bankave

janar-mars 2012

ÇËSHTJE OPERACIONALE

Propozimet për ndryshime në Ligjin për Sigurimin e Depozitave

Agjencia e Sigurimit të Depozitave (ASD) përgatiti, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë dhe bazuar mbi rekomandimet e misionit të Bankës Botërore për forcimin dhe modernizimin e kapaciteteve të ASD-së, projektin për ndryshime në Ligjin për Sigurimin e Depozitave.

Një ndryshim i rëndësishëm që propozohet është ai i rritjes së kompetencave ligjore të ASD në funksion të mbledhjes së një kontributi të veçantë, për mbrojtjen e rezervave të fondit të saj në rast të kryerjes së një procesi kompensimi. Bankat paraqitën komentet dhe objeksionet përkatëse në lidhje me këtë propozim, nëpërmjet shkresave dërguar Institucioneve relevante.

Ndryshime në raportimet e bankave në BSH për administrimin e rrezikut të likuiditetit

Banka e Shqipërisë prezantoi në janar iniciativën për hartimin e një pakete të re raportuese nga bankat me qëllim administrimin dhe monitorimin më të mirë të likuiditetit. Për të diskutuar këtë paketë, AAB organizoi takime të përfaqësuesve të bankave mes tyre si edhe me përfaqësues të BSH, ku u propozuan ndryshimet e përshtatjet përkatëse.

Takim me Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave

Në shkurt 2012, AAB organizoi një takim me përfaqësuesit e bankave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore. Në këtë takim u diskutua lidhur me problematikat që hasin bankat me urdhrat e shpeshtë të bllokimit të llogarive që vijnë nga kjo Drejtori dhe gjetjen e zgjidhjeve të mundshme brenda kuadrit ligjor. Të dyja palët theksuan rëndësinë e krijimit të mundësisë së shkëmbimit elektronik të informacionit, dhe të vendosjes së një marrëveshjeje bashkëpunimi të mirëpërcaktuar midis bankave dhe Drejtorisë.

Seminari dhe Projekt Udhëzimet e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

AAB mbështeti Zyrën e Komisionerit për organizimin e një seminari në lidhje me Procesimin e të Dhënave Personale në Sektorin Financiar, në kuadrin e implementimit të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Në vijim, komitetet teknike të AAB-së zhvilluan mbledhje speciale gjatë muajit shkurt për të diskutuar mbi dy Projekt Udhëzime të përgatitura në zbatim të Ligjit të sipërpërmendur. Komentet e bankave u përmbledhën në një material që Sekretariati i AAB-së dërgoi për Zyrën e Komisionerit në fund të shkurtit 2012.

AKTIVITETI I KOMITETEVE TË AAB-SË

Komiteti i Burimeve Njerëzore

Në përmbushje të kërkesave të legjislacionit fiskal për raportimin e deklaratave tatimore vetëm elektronikisht, bankat u ndeshën në janar me probleme që lidhen me numrin e madh të punonjësve por edhe me strukturat e profesioneve. Kryesia e Komitetit të Burimeve Njerëzore u takua në janar me Drejtorinë Tatimore të Tiranës, për gjetjen e një zgjidhjeje teknike/informatike për transferimin e të dhënave të bankave dhe eliminimin e gabimeve nga deklarimi voluminoz manual. Ky takim u ndoq edhe nga një shkresë zyrtare për të cilën po pritet akoma përgjigje.

Gjithashtu, Komiteti i Burimeve Njerëzore pati edhe një takim me përfaqësues të Sektorit të Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale pranë Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional, në lidhje me qartësimin dhe sugjerime mbi Listën e Profesioneve të cilës i referohet edhe detyrimi për deklarimin online të deklaratave për punëmarrësit. Nga përfaqësuesit e kësaj Agjencie u morr angazhim që, nëse do të shikohet e nevojshme mund të bëhen ndryshime në listë sipas nevojave specifike të bankave.

Komiteti Ligjor

Komiteti Ligjor pati një takim në mars me përfaqësues të misionit të Bankës Botërore për vlerësimin e sektorit financiar, për të diskutuar mbi zgjidhjen e problemeve me ekzekutimin e kolateralit.

Gjithashtu, Kryetarja e Komitetit, Zj. Veronika Prifti mori pjesë në emër të AAB-së, në tryezën e ekspertëve për diskutimin e projektligjit për Gjykatat Administrative të organizuar në mars, nga Komisioni i Ligjeve të Kuvendit të Shqipërisë me komunitetin e biznesit.

Komiteti për Sistemet e Pagesave

Komiteti për Sistemet e Pagesave vlerësoi kushtet dhe mundësitë për realizimin e projektit për heqjen e komisionet vendase mbi transfertat për pagat e punonjësve, duke konsideruar të domosdoshme eliminimin e shkëmbimit manual të informacionit për pagat e punonjësve, veçanërisht për administratën publike. Për këtë qëllim, Komiteti do të bashkëpunojë me Departamentin e Administratës Publike (DAP) për të gjetur zgjidhje të përbashkëta.

Gjithashtu, Kryesia e Komitetit po bashkëpunon me Departamentin e Pagesave në Bankën e Shqipërisë për unifikimin e formave të urdhër-pagesave për të gjithë sistemin bankar.

Komiteti i AAB-së për Sigurinë Bankare

Kryesia e Komitetit për Sigurinë Bankare pati disa takime në janar 2011 me punonjës të degëve të bankave tregtare në Durrës, dhe me drejtues të SHRSF-ve e të Policisë së Shtetit. Qëllimi i këtyre takimeve ishte inspektimi i masave të sigurisë fizike në degët e bankave dhe intensifikimi i bashkëpunimit mes shërbimeve të sigurisë fizike të Bankave me SHRSF-të dhe Policinë e Shtetit, me qëllim rritjen e sigurisë dhe parandalimin e grabitjeve dhe ngjarjeve kriminale në sistemin bankar në qytetin e Durrësit. Komiteti pati gjithashtu një takim urgjent pas ngjarjes tragjike të grabitjes së agjencisë së një banke në Tiranë në 27 mars, ku u diskutua mbi të gjitha masat që duhet të marrin bankat në bashkëpunim edhe me forcat e Policisë së Shtetit.

Krijohet Komiteti i Auditorëve të Brendshëm të Bankave

Në mbledhjen e organizuar nga AAB në shkurt, me Auditorët e Brendshëm të bankave, u vendos për krijimin e një Komiteti të Auditorëve për të mundësuar shkëmbimin e informacionit rreth skemave të mashtrimeve, përpunueshmërisë me kuadrin rregullues dhe me standardet e ndryshme të auditorëve, mundësi trajnimi, etj.

TRAJNIME DHE EVENTE ORGANIZUAR NGA AAB

Forumi shqiptar për sigurinë bankare

AAB dhe Komiteti i saj për Sigurinë Bankare organizuan në 31 janar 2012 Forumin Shqiptar për Sigurinë Bankare. Ky Forum pati si qëllim rritjen e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet aktorëve dhe operatorëve të përfshirë në çështjet e sigurisë bankare në Shqipëri e në Kosovë.

Në Forum pati të ftuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Banka e Shqipërisë, Shoqëritë e Ruajtjes së Sigurisë Fizike (SHRSF), Kompanitë që projektajnë, aplikojnë dhe mbështesin me sisteme të mbrojtjes elektronike. Të ftuar special në këtë aktivitet ishin përfaqësuesit e strukturave të sigurisë fizike të bankave ProCredit, Raiffeisen dhe Banka për Biznes, të shtetit të Kosovës. Të ftuarit dhe pjesëmarrësit vlerësuan maksimalisht Forumin dhe theksuan nevojën që ai të pasohet me aktivitete të tjera të ngjashme me pjesëmarrje më të gjerë.



Pritje lamtumire

AAB-ja organizoi në muajin shkurt 2012 një koktej lamtumire për z. Andreas Galatoulas, i cili u largua nga pozicioni i Drejtorit të Përgjithshëm të Alpha Bank dhe nga Shqipëria, ku iu dha mirëseardhja në Shoqatë edhe Drejtorit të ri të Alpha Bank, z. Periklis Drougkas.



Kurs Trajnimi për Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS)

AAB organizoi një kurs trajnimi 3 ditor (13-15 shkurt) në ambientet e veta, më temë "IFRS Introductory Module" ku morën pjesë përfaqësues nga Alpha Bank, Banka Kombëtare Tregtare, Banka Ndërkombëtare Tregtare, Intesa SanPaolo Bank, ProCredit Bank, Union Bank dhe Banka e Bashkuar e Shqipërisë.

Në këtë kurs u trajtuan veçanërisht IFRS-të që rregullojnë veprimtarinë bankare, tashmë të detyrueshme për t'u aplikuar nga bankat në Shqipëri. Seksionet ishin të strukturuar për të trajtuar standardet si në nivel teorik ashtu edhe në nivel praktik nëpërmjet ushtrimeve dhe rasteve studimore.

Seminar trajnimi organizuar nga AAB dhe DPPP

AAB në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP), organizuan në 27 shkurt 2012 seminarin e trajnimit me temë: "Lufta kundër pastrimit të parave, rregullat bazë dhe kuadri ligjor e rregullator". Këtë seminar e hapi Drejtori i Përgjithshëm i DPPP-së, dhe e ndoqën përfaqësues të DPPP-së, përgjegjësit dhe specialistë në

çështje të parandalimit të pastrimit të parave në bankat tregtare, dhe përfaqësues të Bankës së Shqipërisë. Seminari kishte për qëllim diskutimin në detaje të rasteve konkrete të vigjilencës së zgjeruar të bankave për raste të pastrimit të parave, si dhe praktikat më të mira të raportimit nga bankat tek Autoriteti sipas kërkesave të kuadrit rregullator.

Trajnim mbi Ekzekutimin e Kolateraleve Bankare

AAB në bashkëpunim me Universitetin LUARASI, organizoi kursin e trajnimit me temë "Ekzekutimi i Kolateraleve Bankare", në ambientet e Universitetit, në datat 23-24 dhe 30-31 mars 2012. Lektorët në këtë trajnim ishin Zj. LEDIA PLAKU dhe Z. MARKE-LJAN RRISKA, nga Intesa SanPaolo Bank, të cilët përparimisht një material të plotë mbi temën. Trajnimi u ndoq nga 22 pjesëmarrës nga bankat anëtare dhe katër përfaqësues nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor Privat, dhe ishte ndërtuar në mënyrë të tillë që t'u transmetonte pjesëmarrësve njohuritë, konceptet dhe nocionet e procesit të ekzekutimit të detyrimeve të rrjedhur nga titujt ekzekutivë në kushtet kur ekzekutimi i detyrueshëm përben një element të rëndësishëm në veprimtarinë e bankave.

Në përfundim të kursit të gjithë pjesëmarrësit morën një certifikatë të njohur nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, dhe përfituan dy kredite të vlefshme për sistemin e arsimit të lartë sipas Ligjit "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë".



